

MONITORIMI I PUNËS SË **MEKANIZMAVE TË KOORDINUAR TË REFERIMIT** GJATË PERIUDHËS PANDEMIKE **COVID-19**

BASHKITË

Durrës, Elbasan, Fier,
Kamëz, Korçë, Lezhë,
Pogradec, Sarandë,
Shkodër, Vlorë, Tiranë

Mars - Prill
2020

Pergatiti:
Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"



UNITED NATIONS
ALBANIA



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

SHËNIM

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), me mbështetjen e UN Women, në kuadrin e projektit "Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të "Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020". Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.

Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e UN Women dhe Qeverisë së Suedisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	9
MASAT E MARRA NGA QEVERIA SHQIPTARE GJATË KRIZËS COVID-19	10
BASHKIA DURRËS	14
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Durrës	14
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës	15
Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës	15
BASHKIA ELBASAN	17
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Elbasan	17
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Elbasan	18
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Elbasan	18
BASHKIA FIER	20
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Fier	20
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Fier	21
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Fier	21
BASHKIA KAMËZ	22
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Kamëz	22
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz	22
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Kamëz	23
BASHKIA KORÇË	24
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Korçë	24
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Korçë	25
Të dhëna nga Drejtoria Vendore të Policisë Korçë	25
BASHKIA LEZHË	26
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Lezhë	26
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Lezhë	26
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Lezhë	27

BASHKIA POGRADEC	28
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Pogradec	28
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Pogradec	28
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Pogradec	29
BASHKIA SARANDË	30
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Sarandë	30
Statistika nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	30
Të dhëna nga Drejtoria vendore e Policisë Sarandë	31
BASHKIA SHKODËR	32
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Shkodër	32
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Shkodër	32
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Shkodër	33
BASHKIA VLORË	35
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Vlorë	35
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Vlorë	36
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Vlorë	36
BASHKIA TIRANË	37
Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Tiranë	38
Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë	39
Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë	40
TË DHËNA NGA DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT	41
VEPRIMTARIA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË NIVEL KOMBËTAR E LOKAL	42
KONKLUZIONE	48
REKOMANDIME	50

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhëna nga MKR Durrës	15
Tabela 2. Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës	15
Tabela 3. Të dhëna për dhunën në familje Durrës	16
Tabela 4. Të dhëna nga MKR Elbasan	18
Tabela 5. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	18
Tabela 6. Të dhëna për dhunën në familje Elbasan	19
Tabela 7. Të dhëna nga MKR Fier	20
Tabela 8. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	20
Tabela 9. Të dhëna për dhunën në familje Fier	21
Tabela 10. Të dhëna nga MKR Kamëz	22
Tabela 11. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz	23
Tabela 12. Të dhëna për dhunën në familje Kamëz	23
Tabela 13. Të dhëna nga MKR Korçë	24
Tabela 14. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	23
Tabela 15. Të dhëna për dhunën në familje Korçë	24
Tabela 16. Të dhëna nga MKR Lezhë	26
Tabela 17. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	27
Tabela 18. Të dhëna për dhunën në familje Lezhë	27
Tabela 19. Të dhëna nga MKR Pogradec	28
Tabela 20. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Pogradec	29
Tabela 21. Të dhëna për dhunën në familje Pogradec	29
Tabela 22. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	31
Tabela 23. Të dhëna për dhunën në familje Sarandë	31
Tabela 24. Të dhëna nga MKR Shkodër	32
Tabela 25. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	33
Tabela 26. Të dhëna për dhunën në familje Shkodër	34
Tabela 27. Të dhëna nga MKR Vlorë	36
Tabela 28. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	37
Tabela 29. Të dhëna për dhunën në familje Vlorë	37
Tabela 30. Të dhëna nga MKR Tiranë	39
Tabela 31. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	40
Tabela 32. Të dhëna për dhunën në familje Tiranë	41
Tabela 34. Telefonatat e marra nga LKGV në mbarë vendin	42
Tabela 35. Telefonatat e marra nga LKGV sipas bashkive të monitoruara	43

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është hartuar për të sjellë informacion në lidhje me reagimin e koordinuar të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR-ve) në bashkitë nën monitorim, gjatë periudhës së kufizimeve të lëvizjes të vendosura nga Qeveria Shqiptare për të parandaluar përhapjen e Covid-19. Raporti paraqet një analizë të informacionit të marrë nga tre institucione shtetërore: Bashkitë, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor dhe Drejtoritë vendore të Policisë. Për të hartuar këtë raport u konsultuan edhe organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtari në bashkitë përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të grave e vajzave, kundër dhunës në familje.

Për të kuptuar më shumë në lidhje sesi paraqitet fenomeni për Shqipërinë, Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC) ka ndërmarrë nismën e hartimit të këtij raporti, i cili paraqet gjetje nga monitorimi i punës së Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR-ve) në lidhje me situatën e dhunës në familje gjatë izolimit në nivel bashkie. Raporti bazohet në të dhëna zyrtare të cilat janë marrë përmes kërkesave në institucionet shtetërore si Bashkia, Rajonet Vendore të Policisë, Gjykatat, organizata joqeveritare, strehëza. Të dhënat paraprake zyrtare tregojnë numër të pakët të raportuar të rasteve të dhunës në familje, krahasuar me statistikat zyrtare të një viti më parë, që në fakt është një sinjal alarmi, i cili duhet të bëjë më të vëmendshme strukturat përgjegjëse, familjet dhe organizatat e shoqërisë civile që ndjekin dhe mbështesin viktimat e dhunës në familje.

Raporti më poshtë jep informacion të detajuar për punën në çdo bashki në përmbushje të detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga Ligji për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020 si dhe detyrimet ndërkombëtare siç janë Konventa për eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)¹ dhe Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)² si dhe Deklarata e Komitetit të Shteteve Palë të Konventës së Stambollit³, për veprimet qeveritare gjatë shpërthimit të pandemisë aktuale të COVID-19 kundër dhunës me bazë gjinore.

1 <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/cedawindex.aspx>

2 <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home?>

3 <https://rm.coe.int/declaration-committee-of-the-parties-to-ic-covid-/16809e33c6>

GJETJET KRYESORE TË KËTIJ RAPORTI JANË:

- Mekanizmat e Referimit në nivel vendor gjatë periudhës së kufizimeve kanë trajtuar një numër të vogël rastesh të dhunës në familje, krahasuar me numrin e rasteve të referuara pranë organeve të policisë dhe raportimeve pranë Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza nga Bashkitë përkatëse. Jo të gjithë anëtarët e mekanizmave janë përgjigjur në mënyrë të koordinuar në menaxhimin e rasteve, pasi shumica e tyre nuk marrin pjesë në mbledhjet e mekanizmit dhe nuk e kanë prioritetin të punës së tyre dhunën në familje.
- Koordinatori vendor apo punonjësi i barazisë gjinore është i/e mbingarkuar me punë të tjera në bashki, ç'ka tregon nivel shumë të ulët ndërgjegjësimit të kryetarëve të bashkive në lidhje me prioritetin që duhet ti dedikojnë çështjeve të dhunës në familje.
- Bashkitë vazhdojnë të mos investojnë në fushata dhe materiale ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Çdo gjë mbetet në dorë të donatorëve apo organizatave jo qeveritare, e evidentuar edhe gjatë periudhës së pandemisë.
- Përvec Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje (QKTRDhF) ku u strehuan vetëm 4 raste gjatë periudhës së pandemisë asnjë nga bashkitë e mëdha nuk ofron tërësi shërbimesh si strehime emergjente, këshillim psiko-social apo ndihmë ligjore falas, për të gjitha rastet e ndodhura dhe raportuara në nivel vendor. Një ndihmë të madhe japin organizatat e shoqërisë civile të cilat nuk kanë seli apo kapacitete për të ofruar ndihmën e tyre në çdo bashki të monitoruar. Gjatë periudhës së pandemisë puna e organizatave të shoqërisë civile ishte shumë e madhe për këshillimin në distancë, por viktimat e dhunës kishin nevojë për më tepër ndihmë.
- Ndërrimet e shpeshta të Koordinatorëve vendorë apo punonjësve të barazisë gjinore krijojnë boshllëk me muaj të tërë në organizimin e koordinuar të përgjigjes kundër dhunës dhe trajtimit të rasteve. Këta punonjës edhe kur fillojnë punë mbeten në pritje për muaj për të marrë trajnimin përkatës.
- Me miratimin e Aktit Normativ Nr.9 datë 25.03.2020 *"Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"*⁴ u përcaktua shprehimisht zhvillimi i seancave gjyqësore në çështjet familjare me objekt masat mbrojtëse ndaj dhunës në marrdhëniet familjare. Bazuar në këtë akt Gjykatat e Rrethit Gjyqësor në të gjitha bashkitë nën monitorim gjatë pandemisë Covid-19, zhvilluan seanca në lidhje me Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes (UM/UMM) dhe vërtetimet e tyre, duke i konsideruar si çështje me natyrë të ngutshme të vlerësuara rast pas rasti nga Gjyqtari. Në rastin e Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes Gjykata ka vepruar dhe me zhvillimin e këtyre procesve në mungesë të palëve ndërgjyqëse, viktimës dhe dhunuesit, duke u munduar të mos rrezikojë jetën dhe shëndetin e tyre në situatën e COVID-19. Në këtë rast trupi gjykues vlerësonte në lëshimin apo jo të Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes (UM/UMM) provat e përcjella në kërkesë padi nga ana e Drejtorisë Vendore e Policisë së Qarkut (DVPQ).
- Që nga data 9 Mars, është miratuar një protokoll i posaçëm në lidhje me Dhunën në Familje, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu paralelisht, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka lëshuar një letër të posaçme ndaj drejtorive vendore drejtuar Specialistëve

4 <http://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/25/9> Akti Normativ Nr. 9 datë 25.03.2020 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 50 datë 25.03.2020

të Policisë së Zonës (SPZ) dhe personave përgjegjës, për të ushtuar kontrole periodike të zonave ku ka sinjalizime të dhunës në familje. Megjithëse ky është një urdher i rëndësishëm dhe i domosdoshëm jo vetëm në periudha krizash siç ishte COVID-19, nuk dihet zbatueshmëria e tij, pasi nuk ka një raport në lidhje me këtë.

- Gjatë periudhës së karantinës për shkak të COVID-19, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza ka patur një rritje me rreth 30% të numrit të telefonatave të marra në muajin mars, ndërsa gjatë muajit prill janë pritur

50% telefonata më shumë se në prillin e vitit të kaluar. Telefonuesit kanë qenë kryesisht gra dhe vajza, të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, gra të moshuara por edhe njerëz që jetojnë të vetmuar e pa përkrahje, situata e të cilëve ka parë një përkeqësim që pas vendosjes së karantinës. Problematikat kryesore të telefonuesve, përveç dhunës, kanë qenë të natyrës socio-ekonomike dhe gjithashtu raportime të shumta janë regjistruar në lidhje me ankthin dhe depresionin e shkaktuar nga izolimi.

Rekomadimet kryesore të këtij raporti janë:

- Kërkohet funksionim i plotë i mekanizmave të referimit në nivel bashkie dhe përfaqësim i çdo institucioni anëtar në takimet e përmuajshme.
- Mbajtja e minutave të rregullta dhe proces verbaleve të mbledhjeve në rastin e vendimeve të rëndësishme për viktimat e dhunës në familje.
- Angazhim i Institucioneve arsimore në nivel vendor dhe marrja përsipër e detyrimeve që rrjedhin nga ligjet dhe strategjitë në fuqi për tu kujdesur për fëmijët që shoqërojnë rastet e dhunës në familje dhe për të raportuar dhunën sapo e pikasin.
- Anagazhim i Institucioneve shëndetësore në nivel vendor për të raportuar viktimat e dhunës sipas detyrimeve ligjore që këto institucione kanë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (MShMS) në bashkëpunim me donatorët duhet të krijojë një modul trajnimi online që tu vihet në dispozicion Koordinatorëve Vendorë kundër dhunës me bazë gjinore dhe/apo punonjësve të barazisë gjinore në nivel vendor. Punonjësit/et e rinj/reja në këto detyra duhet ta ndjekin dhe të kenë njohuri të mjaftueshme sapo të fillojnë punën e jo të presin me muaj të trajnohen.
- Propozojmë ndryshim në Ligjin për Masa ndaj dhunës në familje në lidhje me vendosjen e sanksioneve për pjesëmarrjen dhe anagazhimin e institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në nivel vendor.

HYRJE

Ndikimi shkatërrues dhe përhapja e shpejtë e koronavirusit kanë bërë që përgjigjet e shëndetit publik të jenë përparësia absolute e qeverive në të gjithë botën. Shqipëria ashtu si vendet e tjera të prekura të zhvilluar apo në zhvillim, po përpiqet të zgjidhë rreziqet që COVID-19 shkakton në shëndetin e qytetarëve dhe njëkohësisht të zbusë pasojat socio-ekonomike të izolimit, ngadalësimit të prodhimit dhe humbjeve të vendeve të punës. Ndërsa Shqipëria si shumë shtete konsideroi menjëherë kufizime në lirinë e lëvizjes dhe distancimin fizik të domosdoshëm për të parandaluar përhapjen e koronavirusit, masa të tilla mund të kufizojnë në mënyrë të pabarabartë aksesin e grave në kujdesin shëndetësor, strehëza të sigurta, arsim, punësim dhe jetë ekonomike. Efektet janë edhe më të rënda për grupet e pafavorizuara të grave siç janë gratë me aftësi të kufizuara, gratë Rome e Egjiptiane, të moshuara, jetime apo ato që jetojnë në zonat e largëta rurale.

Gjatë mbylljes për shkak të pandemisë, gratë dhe vajzat janë më të rrezikuara nga dhuna në familje, seksuale, ekonomike, psikologjike dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore nga partnerët abuzivë, anëtarët e familjes dhe personat e kujdesit. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë në zonat rurale. Shqipëria si shtet palë i Konventës për eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)⁵ dhe Konventës së Këshillit të Europës (Konventa e Stambollit)⁶ për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje kanë detyrim të tregojnë kujdesin e duhur për të parandaluar dhe mbrojtur gratë e vajzat nga dhuna me bazë gjinore, duke zbatuar ligjet në fuqi ndaj abuzuesve. Gjithashtu Shqipëria ka detyrimin të përmbushë Deklaratën e Komitetit të Shteteve Palë të Konventës së Stambollit.⁷ Kjo deklaratë shpreh vullnetin dhe vendosmërinë e Shteteve Palë për t'iu përmbajtur standardeve të Konventës së Stambollit si një burim udhëzimi për veprimet qeveritare gjatë shpërthimit të pandemisë aktuale të COVID-19. Pas rritjes alarmante të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës ndaj grave dhe / ose dhunës në familje të provokuar nga pandemia në të gjithë botën dhe në shumë vende anëtare të Këshillit të Evropës, në deklaratë theksohet rëndësia e parimeve dhe kërkesave të Konventës së Stambollit në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale dhe politikave të integruara në rrethanat aktuale të jashtëzakonshme. Komiteti i Palëve ku Shqipëria është në kryesi, miratoi deklaratën, në rolin e tij si organi ndërqeveritar i detyruar të mbështesë standardet e Konventës së Stambollit, dhe të sigurojë zbatimin e tyre nga shtetet palë në çdo kohë.

Shqipëria duhet të sigurojë që gratë dhe vajzat viktime ose të rrezikuara nga dhuna me bazë gjinore, përfshirë ato që jetojnë në institucione, të kenë një qasje efektive në drejtësi, veçanërisht në urdhrat e mbrojtjes, ndihmën mjekësore dhe psiko-sociale, strehimore dhe programe rehabilitimi.

Pandemia e COVID-19, sikundër në të gjithë botën ka ndikuar jo pak në aspektin ekonomik si dhe në atë social të shqiptarëve dhe rritjen e stresit dhe pasigurisë.⁸ Në bazë të të dhënave nga Linja e Këshillimit për Gra e Vajza ka patur një numër të shtuar të raportimeve për dhunë në familje. Kjo, për shkaqe nga më të ndryshmet që nga ato ekonomiko-sociale deri tek stresi i izolimit, pamundësia për tu larguar dhe frika e infektimit.

Në studimin e fundit të realizuar nga INSTAT,⁹ 61.1% e grave në Shqipëri përjetonin dhunë fizike në kohën kur studimi u krye, në vitin 2018. Të dhënat treguan se më shumë se 1 në 2, apo 56% e grave kishin përjetuar dhunë fizike gjatë jetës së tyre, kishin përjetuar frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi, dhe/ose nervozizëm.¹⁰

5 <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/cedawindex.aspx>

6 <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home?>

7 <https://rm.coe.int/declaration-committee-of-the-parties-to-ic-covid-/16809e33c6>

8 https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Raport_Grate%20e%20varfera%20te%20Fasonerive.pdf

9 INSTAT, 2019. Dhuna ndaj Grave e Vajzave në Shqipëri. Vrojtim Kombëtar me bazë popullatën.

<http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>

10 Ibid

MASAT E MARRA NGA QEVERIA SHQIPTARE GJATË KRIZËS COVID-19

Menjëherë pas fillimit të pandemisë COVID-19, Qeveria e Shqipërisë deklaroi marrjen e masave që lidhen posaçërisht me çështjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke marrë parasysh rrezikun paralajmërues të rritjes ose përshkallëzimit të saj gjatë periudhës së izolimit, siç u dëshmuua qartë nga rritja e numrit të telefonatave dhe raportimeve apo edhe nga vendet e tjera evropiane. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni kryesor për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje duke qenë i ndërgjegjshëm që gratë dhe disa grupe të tjera të cënueshme të shoqërisë sonë, rrezikojnë të preken shumëfish dhe të dëmtohen më shumë nga kjo situatë, ka synuar që të gjitha përgjigjet kundër pandemisë së COVID-19, të jenë të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor. Kjo është mbajtur në konsideratë në të gjitha propozimet për ndërhyrje për grupe dhe kategori të caktuara, të cilat kanë gjetur vend në Vendimet e Këshillit të Ministrave apo të gjitha aktet e tjera nënligjore të miratuara për këtë periudhë emergjence, si dhe në Udhëzime e Urdhëra të lidhura specifikisht me çështjet dhe grupet që mbulon institucioni.

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në veçanti Sektori i Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, që në fillimin e situatës së emergjencës kanë intensifikuar përpjekjet e tyre për të pasur informacion të përditësuar dhe për të menaxhuar në kohë e me përgjegjësi çdo problem të identifikuar në terren, të lidhur me pabarazitë gjinore apo dhunën në familje. Mjaft raste të identifikuar kohët e fundit në disa prej bashkive të vendit janë ndjekur dhe menaxhuar drejtpërsëdrejti nga sektori. Gjatë muajit mars – maj 2020, qendra "LILIUM" ka trajtuar 3 viktima të dhunës seksuale të treja femra, nga të cilat 2 minorene dhe 1 e rritur.
- Në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje (QKTRDhF) kanë përfituar shërbime përkatësisht 4 raste. Në muajin mars pranë QKTRDhF është akomoduar një grua e dhunuar pa fëmijë nga Komisariti i Policisë Kamëz. Në muajin Prill janë akomoduar 2 raste të reja, një rast i një vajzë të mitur e pashoqëruar, viktimë e dhunës seksuale referuar nga Qendra "Lilium" dhe një grua nga Kosova, referuar nga Komisariti i Policisë Kamëz. Ndërsa në muajin maj është akomoduar një grua me tre fëmijë referuar nga Komisariti Tiranë.
- Të mirë informuar që situata të tilla shoqërohen me një rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje, apo dhe përshkallëzim të formave të dhunës, i është dhënë prioritet komunikimit intensiv me të gjithë Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje dhe Nëpunësit e Barazisë Gjinore në të 61 bashkitë në vend, duke iu parashtruar edhe veprimet konkrete që duhet të ndjekin sidomos gjatë kësaj periudhe, për të identifikuar dhe trajtuar me prioritet çdo rast të dhunës në familje. Po kështu janë përcjellë komunikime zyrtare për këtë qëllim ku është saktësuar dhe mënyra se si Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje duhet të veprojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore. Për rrjedhojë, një numër i madh bashkish kanë reaguar duke postuar edhe në faqet e tyre të mediave sociale numrat e telefonit ku mund të kërkojë ndihmë personi i rrezikuar në familje, duke e vënë në dijeni komunitetin se kufizimet nuk e pengojnë aspak mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimit në çdo kohë.
- Një spot informues për rritjen e ndërgjegjësimin të publikut në situatën Covid-19 (shoqëruar edhe me gjuhën e shenjave), është postuar edhe në faqen e internetit të MSHMS.¹¹ Deri në fund të Majit 2020 ky spot ka patur 286 mije shikime.

11 <https://www.facebook.com/MinistriaeShendetesisedheMbrojtjesSociale/videos/252515315870825/>.

- Shërbimi Kombëtar pa pagesë i Linjës Telefonike për Gratë dhe Vajzat 116 117 është në gadishmëri maksimale dhe po përballon edhe fluksin e shtuar të telefonatave për muajt mars e prill 2020 të cilat rezultojnë të rritura në masën 30% dhe 50% krahasuar me të njëjtët muaj të një viti më parë. Për muajin maj rezulton se telefonatat janë trefishuar.
 - Komunikim i vazhdueshëm është mbajtur edhe me Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit Shqiptar, jo vetëm për veprimet e përbashkëta në drejtim të mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve me prioritet për rastet e dhunës në familje, por edhe për të ditur se sa dhe si ka ndikuar pandemia e COVID-19 në shtimin e numrit të rasteve.
 - Për një përgjigje efektive dhe në respektim të standardeve kombëtare e ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve të specializuara për rastet e dhunës ndaj grave e dhunës në familje Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar një Protokoll për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat / të mbijetuarat e dhunës në familje dhe për viktimat / të mbijetuarat e trafikimit gjatë situatës së pandemisë së COVID-19 ". Protokollin është miratuar me Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 254 datë 10 Prill 2020.¹² Qëllimi i këtij Protokollin është të ndihmojë ofruesit e shërbimeve (strehëzat) të funksionojnë sa më efektivisht të jetë e mundur në përputhje me kufizimet për shkak të masave parandaluese. Ai siguron udhëzimet e nevojshme në lidhje me shërbimet e nevojshme për viktimat / të mbijetuarat e dhunës në familje dhe trafikimit pa rrezikuar shëndetin dhe jetën e tyre ose jetën e banorëve të strehëzave, familjeve të tyre dhe komunitetit në përgjithësi. Protokollin u hartua me mbështetjen e UN Women Albania dhe gjithashtu u zhvillua dhe një trajnim online për të gjithë personelin e strehëzave dhe pjesëmarrjen edhe të Koordinatorëve
- Vendore të atyre bashkive ku ekzistojnë këto shërbime (datë 15 maj 2020).
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka aprovuar një "Udhëzim për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqsisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19". (Udhëzimi Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.253, datë 10 Prill 2020). Është hartuar me mbështetjen e UNICEF.
 - "Protokollin për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje" nga anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në nivelin lokal në situatën e emergjencës së COVID-19" është ndarë me 61 bashki për shqyrtim dhe miratim të mëtejshëm nga Komitetet Drejtuese të këtyre Mekanizmave të Koordinuara të Referimit në nivelin lokal, ndërsa gjithashtu ka filluar trajnimi i Koordinatorëve Vendore kundër Dhunës në Familje për këtë qëllim. Së bashku me të është diskutuar dhe po zhvillohet trajnimi edhe për protokollin e menaxhimit të rasteve në kushte jo të emergjencës së COVID-19. (me mbështetjen UNDP Albania). Gjithsej janë trajnuar 33 koordinatorë vendorë, dhe është parashikuar që ky trajnim të mbahet në vijim edhe për pjesën e mbetur të koordinatorëve.
 - Është hartuar rregullorja e brendshme e funksionimit të Qendrës për Menaxhimin e Krizës së Dhunës Seksuale "Lilium" për situatën COVID. Ky është një dokument plotësues përveç Protokollit të aprovuar dhe do të përqendrohet në të gjitha specifikat e shërbimeve që i ofrohen qendrës "Lilium" gjatë pandemisë së COVID-19, ku saktësohen rregullat e reja që duhet të ndiqen nga profesionistët dhe viktimat / e mbijetuarat gjatë procesit të ekzaminimit, etj., si do të mblidhen provat duke shmangur gjithashtu rrezikun e infektimit ose përhapjes së COVID-19, etj. (ky dokument është përgatitur me mbështetjen e UNDP)

12 <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/84/47de6304-1db6-4a2a-b89b-87b05569a06b;q=Urdhrin%20e%20Ministres%20Nr.290,%20date%2004.05.2020>

- Është kryer një vlerësim i shpejtë i nevojave për shërbimet e specializuara të ndihmës që ofrojnë strehim (afatshkurtër ose afatgjatë) për viktimat / të mbijetuarat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përgatitur nga Sektori për Përfshirje Sociale dhe Barazi gjinore në MSHMS, i përqendruar tek identifikimi i: nevojave të tyre për materiale mbrojtëse dhe higjienike për stafin dhe përfituesit e tyre; kapacitetet dhe potencialet e tyre për të krijuar dhomën e izolimit brenda hapësirave të strehëzave; nevojat e tyre për një trajnim të mundshëm për protokollin e ri të funksionimit në emergjencën COVID-19; nevoja e tyre për trajnime dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve, etj. Janë analizuar nevojat e 19 strehëzave (afatshkurtra dhe afatgjata, të përqendruara ofrimin e shërbimeve për dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, fëmijëve të abuzuar në marrëdhëniet familjare ose viktimave / viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe për komunitetin LBGTI, plus qendrën për menaxhimin e krizës së dhunës seksuale.
- Akti normativ Nr. 9 i datës 25.03.2020 nuk ka pezulluar mundësinë për të ngritur padi apo për t'iu drejtuar gjykatës në rastet e çështjeve familjare si kujdestaria, birësimi, përgjegjësia prindërore apo detyrimi për ushqim.
- Po ashtu, duke qenë te vetëdijshëm për rrezikun e mundshëm të shtimit të dhunës në familje, urdhrat mbrojtës dhe çështjet e lidhura me dhunën në familje nuk janë pezulluar.
- Ndërkohë, të miturit në konflikt me ligjin jo vetëm që kanë patur akses në gjykatë për çështje që lidhen me shkeljen e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, por kanë patur edhe një sërë garancish procedurale më shumë krahasuar me periudhën normale.
- Ofrohet ndihmë juridike falas online dhe nëpërmjet numrit të gjelbër online 0800 1010 e hapur pranë Ministrisë së Drejtësisë për qytetarët në nevojë.
- Në lidhje me trajtimin e nevojave ekonomike të grave dhe grupeve të tjera të cënueshme gjatë kësaj periudhe kufizimesh për shkak të COVID-19, janë marrë disa masa, ku më kryesoret, që përfshijnë dhe kërkojnë edhe angazhimin e shoqërisë civile në zbatim, janë:
 - Vendimi nr. 236, datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, i cili parashikon ofrimin e asistencës në banesë, duke përfshirë për dërgimin e pagesave të përfituara nga programi i mbrojtjes sociale dhe sigurimeve shoqërore, dërgimin e produkteve ushqimore e joushqimore dhe barnave të rimbursueshme, duke përcaktuar njëkohësisht edhe kategoritë në nevojë (përfitues të Ndihmës Ekonomike (NE), Persona me Aftësi të Kufizuara, invalidë e pensionistë) që përfitojnë nga këto programe.
 - VKM Nr. 254, datë 27.3.2020 Përpërcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19, parashikon: (i) dhënien e ndihmës financiare për të punësuarit / vetpunësuarit, në nivelin e pagës minimale, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik / marrëdhënive të punës për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID19, (ii) dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike (2-fishi i pagesës së NE); dhe (iii) dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia (2-fishi i pagesës së papunësisë). Për rrjedhojë 482 viktimat/të mbijetuara të dhunës në familje me udhër mbrojtjeje duke filluar nga data 1 prill 2020 përfitojnë për tre muaj dyfishin e mbështetjes ekonomike për shkak të UMM/UM ndërsa nën skemën e ndihmës ekonomike të dhënat progresive flasin për rreth 6000 gra kryefamiljare të cilat përfitojnë ndihmën ekonomike, etj.

Të gjitha sa më sipër si dhe një tërësi aktesh të miratuara gjenden në adresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale [MShMS](#) dhe janë hartuar në bashkëpunim dhe konsultim edhe me një tërësi organizatash të shoqërisë civile, ekspertë të fushës dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, duke mundësuar kështu përshirjen e zërit dhe të perspektivës së vetë grupeve të cenuara.

Në mënyrë më specifike veprimet e qeverisë në këtë drejtim janë pasqyruar edhe në faqen e dedikuar të [Këshillit të Evropës](#) pikërisht për çështje të barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave.

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Durrës

- Gjatë periudhës mars, prill 2020 që përkon me pandeminë, janë trajtuar 38 raste të viktimave të dhunës të pajisura me Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Bashkisë Durrës (MKR- Durrës). Të gjitha rastet janë trajtuar vetëm nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë bashkisë, por pa mbajtur proces verbale apo minuta takimi dhe në mungesë të anëtarëve të tjerë të mekanizmit.
- Gjatë periudhës mars - prill 2020 Bashkia Durrës ka mbështetur me ndihma ushqimore dhe sete higjienike 23 raste viktime të dhunës në familje, nga këto 17 raste në qytet dhe 6 raste në zonat rurale.
- Gjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 bashkia Durrës nuk ka shpërndarë poster me informacionin e nevojshëm se ku mund të kërkohet ndihmë në rastet e dhunës dhe kontaktet e nevojshme dhe nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë sensibilizuese përmes posterave, web-it¹³ të saj, apo përmes faqes zyrtare në rrjetin social Facebook.¹⁴
- Përgjatë situatës pandemike, nga Bashkia Durrës është menaxhuar situata e një gruaje dhe fëmijës së saj të mitur 2-vjeç në situatë rruge pas denoncimit të bërë publik në media. Ky rast është strehuar në një nga organizatat që ofrojnë shërbime për gratë e dhunuara në qytetin e Tiranës.
- Gjatë periudhës mars - prill 2020, aktorë të veçantë të Mekanizmit të Referimit Durrës pohojnë që kanë trajtuar raste të viktimave të dhunës në familje. Sipas përfaqësuesve të bashkisë takimet e MKR-së mbahen pa shënime/minuta takimi ndaj është e vështirë të nxjerrësh numrin e trajtuar të viktimave të dhunës nëpër këto takime. Përgjatë periudhës pandemike nuk është mbajtur asnjë mbledhje e Mekanizmit të Referimit.
- Përgjatë kësaj kohë Grupi Teknik Ndërdisciplinar (GTN) nuk është mbledhur. Të gjitha rastet janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë Durrës, në bashkëpunim të ngushtë më disa nga aktorët kryesore të MKR-së si: Policia Vendore e Policisë Durrës, organizatat e shoqërisë civile (Shoqata "Gender, Paqe e Siguri", QZHK "Sot për të Ardhmen", World Vision), Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës.

13 <https://www.durres.gov.al/>

14 <https://www.facebook.com/durres.gov.al>

Tabela 1. Të dhëna nga MKR Durrës

Muaji	Rastet me UMM të trajtuara nga Bashkia
Mars	15
Prill	23

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës

- Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga muaji janar – prill 2020 janë paraqitur në total 123 kërkesë padi për lëshimin e Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrotjes (UMM) dhe Urdhrave të Mbrojtje (UM), sipas kësaj shpërndarje:
- Në muajin janar: Janë paraqitur 45 kërkesa me objekt UM dhe UMM nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut (DVPQ Durrës).
- Në muajin shkurt: Janë paraqitur 50 kërkesa me objekt UM dhe UMM nga DVPQ Durrës.
- 1 mars -31 prill : Janë paraqitur 28 kërkesa me objekt UM dhe UMM nga DVPQ Durrës.

Ne tabelën vijuese gjenden të detajuara vendimet e kësaj gjykate për periudhën kohore janar – prill 2020.

Tabela 2. Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës

Periudha Kohore 2020				
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje				
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	45	50	28	
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4		6		

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Siç shihet në tabelë nga 123 Vendime UMM në fazën e parë janë lëshuar 117 vendime në favor të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare ndërsa 6 kërkesë padi janë rrëzuar. Në fazën e dytë, në seancat e vërtetimit të UMM janë zgjatur efektet e UMM në 19 raste, ndërsa 98 gjykimet e tjera janë pushuar. Pushimi i UMM-ve ndodh kryesisht për mungesën e provave që gjatë kohëzgjatjes së tij nuk ka pasur dhunë mes viktimës dhe dhunuesit, në herë të tjera për mungesën e paraqitjes së viktimës paditëse para Gjykatës.

Në lidhje gjykimet penale Dhunë në Familje janë gjykuar dhe shpallur 6 vendime për nenin 130/a, 1,2,3,4 të Kodit Penal të cilat ishin të gjitha vendime fajësie, 3 prej tyre janë përsëritës në përgjithësi të veprave penale.

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 158 raste dhunë në familje. Të dëmtuar gjithsej ishin 158 individë, ku 109 prej tyre ishin gra/vajza. Ndërkohë që 101 ishin gjithsej kërkesat për UMM dhe UM dhe 8 ishin rastet kur UMM dhe UM ishin shkelur.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 38 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, të shoqëruara me dy humbje jete, 13 persona të arrestuar, 1 person i ndaluar dhe 25 persona të hetuar në gjëndje të lirë.

Tabela 3. Të dhëna për dhunën në familje Durrës

Përshkrimi	Komisariati Durrës
Evidentuar	158
Tëdëmtuargjithsej	158
Prejtyregra/vajza	109
K-P.U. Mbrojtje	101
Sh.U. Mbrojtjes	8
V. P. Neni 130/a	38
Vrasjeraste/viktima	2/2
Arrest. për 130/a	13
Ndaluar për 130/a	1
GjendjetëLirëpër 130/a	25
Nëkërkimpër 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nga të dhënat e fundit të përfituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pranë policisë vendore bashkia Durrës, për muajin mars 2020 janë paraqitur 18 kërkesa për UM, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 24 kërkesa të tilla, duke patur një rritje të kërkesës për ndihmë me 33 %. Rritje evidentohet edhe në rastet e shkeljes së UM/UMM, ku gjatë muajin mars u rregjistruan 2 raste të tilla, ndërsa në muajin prill këto shkelje u dyfishuan duke rregjistruar 4 shkelje të UM/UMM. Një rritje e konsiderueshme pasqyrohet edhe për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a¹⁵ të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19.

Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Durrës evidentoi 7 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 2 agresorë, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale u rrit me pothuajse 72 %, duke regjistruar 12 raste të tilla ku u arrestua 1 agresor.

15 **Neni 130/a Dhuna në familje** (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33) – 130/a1Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. 130/a2Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. 130/a3Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. 130/a4Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

BASHKIA ELBASAN

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Elbasan

- Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i Mekanizmit të Referimit pranë bashkisë Elbasan ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Komunikimi midis antarëve është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me Specialistët e Policisë së Zonës (SPZ).
- Gjatë periudhës janar-prill 2020 nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) të Bashkisë Elbasan janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 36 raste të dhunës në familje. Nga të cilët 11 raste me UMM dhe 10 raste UM, 7 raste të mbështetura me shërbime për të parandaluar dhunën në familje. Gjithashtu mbështetja dhe monitorimi ka vazhduar edhe për 29 raste të mbartura nga viti 2019, të cilave nuk i ka mbaruar afati kohor i mbrojtjes nga UM.
- Koordinatorja Vendore në Bashkinë Elbasan i ka kryer funksionet e saj të plota, sipas grafikut të paraqitjes në zyrë dhe masave mbrojtëse të marra gjatë pandemisë. Komunikimin, monitorimin dhe menaxhimin e rasteve e ka realizuar nëpërmjet bisedave telefonike dhe takimeve të drejtëpërdrejta duke ruajtur distancat e sigurisë.
- Bashkia Elbasan ka ofruar 45 pako ushqimore dhe sanitare për viktimat e dhunës në familje përgjatë situatës pandemike. Gjithashtu ka ofruar këshillim psiko-social, informim dhe referim nëpërmjet bisedave telefonike. Për rastet e reja të pajisur me UM gjatë kësaj periudhe, u është ofruar aplikimi online nga koordinatori vendore për ndihmën ekonomike për shkak të UM.
- Gjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga Covid-19, Bashkia Elbasan ka shpërndarë informacion online, në faqen zyrtare të internetit, facebook, media lokale nëpërmjet dhënies së mesazheve kundër dhunës në familje, dhe si mund të kërkohet ndihmë nëse je i/e dhunuar, duke vënë në dispozicion kontaktet e nevojshme si të Koordinatorës vendore, Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijeve, policisë dhe psikologe.
- Gjatë periudhës mars – prill, Grupi Teknik Ndërdisciplinar (GTN) nuk është mbledhur. Të gjitha rastet janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve të kujdesit Social të Bashkisë së Elbasanit, si dhe nga specialistët e Policimit në Komunitet dhe anëtarët e tjerë të MKR-së, si Policia Vendore Elbasan, Njësia e Mbrojtjes për të drejtat e fëmijeve, organizatat e shoqërisë civile si A2B, Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulture, Tjetër Vizion, Forumi i Gruas Elbasan etj.
- Në Bashkinë e Elbasanit funksionon "Zyra për keshillimin e burrave dhunues", e manaxhuar nga Shoqata "Tjetër Vizion", e cila ofron programe këshillimi dhe rehabilitimi për dhunuesit. Përgjatë kësaj kohe ata kanë vazhduar ofrimin e shërbimeve të tyre nëpërmjet këshillimit online/telefonik. Për periudhën mars - prill 2020 kjo shoqatë ka ofruar këshillim për 6 raste burrash dhunues, raste këto të evidentuara në bashkëpunim me koordinatoren e MKR dhe komisariatit e policisë Elbasan.
- Në MKR e Bashkisë Elbasan janë referuar 50 raste kryesisht për paketa ushqimore, aplikimin për marrjen e ndihmës ekonomike on-line, verifikimin e situatës në familje sidomos në rastet ku gratë megjithëse me UMM/UM, kanë vazhduar të jetojnë në të njëjtën banesë me dhunuesit.

Tabela 4. Të dhëna nga MKR Elbasan

Muaji	UMM
Janar	10
Shkurt	9
Mars	7
Prill	10

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 4-mujorin e parë të vitit 2020 janë paraqitur gjithsej 36 kërkesa për Urdhra Mbrojtje (UM) dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM), nga të cilat: 16 janë pranuar; 14 janë hedhur poshtë dhe 7 janë pushuar.

Tabela 5. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Përshkrimi	Periudha Kohore 2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	7	3	3	4
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	1	2	0	1
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4	8	4	1	

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Në lidhje me gjykimet penale "Dhunë në Familje", janë gjykuar dhe shpallur vendime për nenin 130/a, 1,2,3,4 të Kodit Penal në total 13 vendime për Urdhra Mbrojtje dhe 3 vendime për Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Nga të dhënat e gjykatës Elbasan rastet e dhunës në familje janë më shumë evidente brenda nuklit familjar midis bashkëshorteve me një numër të konsiderueshëm prej 21 rastesh dhe me pas konfliktet në marrëdhëniet familjare me të tjerë me një numër prej 13 rastesh.

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Elbasan

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 6 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 7 individë. Nga ku 5 prej viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 4 ishin gjithsej kërkesat për UM dhe UMM. Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 2 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku u arrestuan 2 agresorë.

Tabela 6. Të dhëna për dhunën në familje Elbasan

Përshkrimi	Komisariati Elbasan
Evidentuar	6
Të dëmtuar gjithsej	7
Prej tyre gra/vajza	5
KP.U. Mbrojtje	4
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	2
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	2
Ndaluar për 130/a	0
Gjendje të Lirë për 130/a	0
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë policisë vendore bashkia Elbasan, për muajin mars 2020 janë paraqitur 5 kërkesa për UM/UMM, dhe po njësoj 5 kërkesa u evidentuan edhe gjatë muajit prill. Gjatë këtyre dy muajve nuk u evidentuan shkelje të UM/UMM. Një rritje e konsiderueshme pasqyrohet për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Elbasan evidentoi 2 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 1 agresor, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale u rrit me pothuajse 200 %, duke regjistruar 6 raste të tilla ku u arrestuan 4 agresorë.

BASHKIA FIER

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Fier

- Mekanizmi i Referimit (MKR) pranë Bashkisë Fier gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill 2020 ka trajtuar në total 29 raste dhe viktimat e dhunës në familje janë orientuar nga koordinatoresja e vendore kundër dhunës në familje dhe janë shoqëruar pranë familjarëve të tjerë, si: prindër, motra, vëllezër. Sipas koordinatores, komunikimi me Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ), kryetarët e rajoneve, kryepjeqitë e fshtrave, sipas vendbanimit të viktimave dhe familjarëve të tyre ku janë vendosur si dhe me administratorët socialë dhe me viktimat e dhunës ka qenë i vazhdueshëm dhe i pandërprerë.
- Gjatë periudhës së pandemisë, koordinatoresja vendore pranë kësaj bashkie ka punuar me orare të reduktuara, në zyrë dhe ndjekjen e punës për orët e tjera e ka kryer nga ambjentet e shtëpisë.
- Mekanizmi i Referimit është angazhuar për të zbutur problematikat e shfaqura gjatë situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19. Nga ky sektor janë shpërndarë informacione si në rrjetet sociale dhe në komunikime individuale me viktimat e dhunës, për sensibilizimin e tyre, si dhe për denoncimin në polici. 4 prej viktimave i janë referuar Shërbimit Ligjor Falas dhe janë mbështetur nga ky shërbim.
- Gjatë kësaj periudhe viktimat e dhunës janë mbështetur edhe me paketa ushqimore. Viktimat e dhunës në familje që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Urdhri i Mbrojtjes, janë paguar për muajin mars me pagesë të dyfishuar, sipas vendimit të qeverisë.
- Përsa i përket Programeve të Këshillimit për Dhunuesit, është një shërbim i munguar në Bashkinë Fier.
- Janë rreth 30 viktima të dhunës në familje (raste të reja dhe të mbartura) të cilat bashkia i ka ndihmuar, duke bashkëpunuar me Kishën Ortodokse dhe Shoqatën "Selam".
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza për bashkinë Fier gjatë muajit mars –prill 2020 ka marrë 79 telefonata, specifikisht 42 telefonata në muajin mars dhe 37 të tilla në muajin prill.

Tabela 7. Të dhëna nga MKR Fier

Muaji	UMM
Janar	10
Shkurt	8
Mars	4
Prill	7

Burimi: Bashkia Fier

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Fier

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në 4-mujorin e parë të 2020 janë pranuar gjithsej 28 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) të ndara në muaj sipas tabelës më poshtë.

Tabela 8. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

Përshkrimi	Periudha Kohore 2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	6	7	2	7
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	1	3	1	1
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4				

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Fier

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 45 raste dhunë në familje ku 35 prej tyre ishin gra/vajza.

Në vijim, 32 gjithsej ishin kërkesat për UMM dhe UM dhe 2 ishin rastet e shkeljes së këtyre urdhrave.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 9 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 6 agresorë, u ndalua 1 agresor dhe 2 prej tyre janë në gjendje të lirë. Tabela vijuese pasqyron në detaje statistikat në lidhje me rastet e dhunë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Tabela 9. Të dhëna për dhunën në familje Fier

Përshkrimi	Komisariati Fier
Evidentuar	45
Të dëmtuar gjithsej	45
Prej tyre gra/vajza	35
K-P.U. Mbrojtje	32
Sh.U. Mbrojtjes	2
V. P. Neni 130/a	9
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	6
Ndaluar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	2
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë policisë vendore bashkia Fier, për muajin mars 2020 janë paraqitur 6 kërkesa për UM, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 10 kërkesa të tilla, duke patur një rritje të kërkesës për ndihmë me 66 %. Nga ana tjetër nuk u evidentua asnjë rast i shkeljes së UM/UMM. Një rritje pasqyrohet edhe për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a[1] të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin Mars, Policia Vendore e Bashkisë Fier evidentoi 3 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 1 agresor, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale regjistroi 4 të tillë me arrestimin e vetëm një agresori.

BASHKIA KAMËZ

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Kamëz

- Koordinatorja e dhunës pranë Mekanizmit të Referimit (MKR) në bashkinë Kamëz edhe pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë COVID-19, është paraqitur çdo ditë në punë në mënyrë të rregullt për trajtimin e rasteve, sipas nevojave që kanë patur specifikisht secili prej tyre, por janë menaxhuar në bazë të komunikimeve me telefon ose online me anëtarë të tjerë të MKR dhe nuk ka patur një mirëorganizim të këtij entiteti gjatë kohës së mbylljes për shkak të pandemisë.
- Përveç detyrave specifike në trajtimin e rasteve, koordinatores i janë caktuar edhe detyra të tjera si shpërndarje e pakove ushqimore për viktimat e dhunës, rastet e fëmijëve në situatë rruge, ndihmë për punonjësit e ndihmës ekonomike për familjet të cilat kanë aplikuar për të përfituar këtë ndihmë.
- Nga muaji janari deri në fund të muajit prill, 4 viktima të dhunës në familje kanë përfituar bonus qeraje, 24 familje janë asistuar me pako ushqimore dhe gjithashtu me vendim qeverie për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 të gjithë viktimat e dhunës të cilët përfitojnë pagesën nga UM kanë përfituar dyfishimin e saj, nga 3000 në 6000 lekë/muaj për të gjithë kohëzgjatjen e Urdhrit të Mbrojtjes.
- Që nga fillimi i janarit 2020 dhe deri në fund të muajit prill MKR Kamëz ka trajtuar gjithsej 14 raste të reja, ku për muajin mars janë trajtuar 2 raste ndërsa në muajin prill 4 raste të reja. Përveç rasteve të reja, janë trajtuar dhe menaxhuar edhe raste të mbartura të vitit 2019 për shkak të projekteve të mëhershme dhe situatës së krijuar nga COVID-19.
- Për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në familje gjatë periudhës së vështirë të mbylljes për shkak të pandemisë, organizata ndërkombëtare USAID me projektin "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore" ka ndihmuar bashkinë Kamëz, që të përgatisë dhe të zhvillojë një fushatë informimi të komunitetit. Është përgatitur një poster i cili është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë me mesazh sensibilizues që kujton se dhuna në familje është vepër penale, si dhe që viktimat e dhunës mund të telefonojnë në çdo kohë dhe të denoncojnë rastet apo të kërkojnë ndihmë. Në poster është përfshirë krahas numrit të policisë dhe Linjës Kombëtare të Këshillimit edhe numri i telefonit i Koordinatorës.
- Pranë bashkisë Kamëz gjatë periudhës janar – prill, kanë mbërritur nga gjykata 28 Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) të cilat kanë qenë me efekt pagese mujore. Në vijim, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza për bashkinë Kamëz gjatë muajit mars –prill 2020 ka marrë 218 telefonata, specifikisht 101 telefonata në muajin mars dhe 117 të tilla në muajin Prill.

Tabela 10. Të dhëna nga MKR Kamëz

Muaji	UMM
Janar	3
Shkurt	5
Mars	2
Prill	4

Burimi: Bashkia Kamëz

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz

Sipas të dhënave të përfituara nga koordinatorja vendore pranë bashkisë Kamëz, gjatë periudhës janar - prill, pranë kësaj bashkie janë paraqitur 33 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes të pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz.

Kjo gjykatë nuk ka një zyrë statistikash dhe nuk i ndan rastet në rang bashkie apo me të dhëna të tjera.

Tabela 11. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për bashkinë Kamëz

Periudha Kohore 2020				
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	4	1	1	7
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	4	4	4	8

Burimi: Koordinatorja Vendore

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Kamëz

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Kamëz për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 63 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 66 individë (Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar), ku 46 prej rasteve të viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 33 ishin gjithsej kërkesat për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) dhe kishte një rast shkelje të këtyre urdhrave.

Gjatë 3 muajit të parë të vitit 2020, 23 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 8 agresorë, u ndalua 1 dhe 12 prej tyre janë në gjendje të lirë. Gjatë tremujorit të parë të vitit në bashkinë Kamëz regjistrohet një rast me vrasje të viktimës së dhunës.

Tabela 12. Të dhëna për dhunën në familje Kamëz

Përshkrimi	Komisariati Kamëz
Evidentuar	63
Të dëmtuar gjithsej	66
Prej tyre gra/vajza	46
Kërkesë për U.M	33
Shkelje U.M	1
Vepër Penale Neni 130/a	23
Vrasje raste/viktima	1/1
Arrest. për 130/a	8
Ndaluar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	12
Në kërkim për 130/a	2
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë Policisë Vendore Bashkia Kamëz, për muajin Mars 2020 janë paraqitur 11 kërkesa për Urdhër Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 12 kërkesa të tilla. Gjatë këtyre dy muajve nuk u sinjalizua asnjë rast i shkeljes së UM/UMM. Një rritje e lehtë pasqyrohet për veprën penale "Dhunë në familje" sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin Mars, policia vendore e bashkisë Kamëz evidentoi 5 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 1 agresor, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale ishte 6 raste të tilla ku sinjalizohet që nuk është arrestuar asnjë agresor.

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Korçë

- Pavarsisht se MKR Korçë në total ka trajtuar 10 raste të regjistruara, antarë të veçantë të saj kanë punuar me intensitet për asistimin e rasteve të evidentuara siç ka qenë Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, Prokuroria, Koordinatorja vendore dhe psikologjia e Prokurorisë të cilat kanë asistuar të 31 rastet e evidentuara nga policia.
- Gjatë periudhës së mbylljes pandemike ky mekanizëm ka trajtuar 6 raste të dhunës në familje, 3 në muajin mars dhe 3 në muajin prill.
- Koordinatorja vendore ka vazhduar punën normalisht. Për çdo rast dhune të raportuar në polici ka qenë e pranishme duke i ofruar mbështetje viktimave të dhunës për nevojat që kanë paraqitur. Gjithashtu koordinatori është përfshirë gjatë kësaj periudhe në shërbimin e ndihmës për pensionistët dhe familjet në nevojë, fillimisht duke hartuar një listë të të gjithë pensionistëve të vetmuar dhe nevojat që ata kishin. Ajo ka përgatitur lista të përfitueseve të familjeve në nevojë për të përfituar pako ushqimore dhe produkte higjieno-sanitare.
- Komunikimin, monitorimin dhe menaxhimin e rasteve koordinatori e ka realizuar nëpërmjet bisedave telefonike dhe takimeve të drejtëpërdrejta duke ruajtur distancat e sigurisë në komisariatit dhe policisë.
- Bashkia Korçë në momentin e parë të përhapjes së COVID-19 përveç ndihmës që po jep për pensionistët e vetmuar dhe njerëzit në nevojë ka afishuar në faqen zyrtare të saj një numër pa pagesë (0800 34-34 Zyra kundër dhunës në familje) për tu ardhur në ndihmë viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ka publikuar materiale ndërgjegjësuese dhe informuese mbi dhunën në familje (Facebook dhe Instagram).
- Takimi i fundit i realizuar nga MKR Korçë është zhvilluar në datën 2.4.2020. Komunikimi është realizuar online për të diskutuar rreth rasteve të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Komunikimi më pas midis anëtarëve është realizuar përmes telefonit, dhe për çdo rast të nevojshëm janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me Specialistët e Policisë së Zonës (SPZ), me të cilët bashkëpunimi ka qenë shumë i ngushtë.
- Viktimat e trajtuara nga MKR Korçë kanë qëndruar në banesat e tyre pasi në bashkëpunim me policinë e komisariatit Korçë është bërë largimi i dhunuesit nga banesa. Janë larguar 5 dhunues nga banesat e tyre.
- 15 gra të dhunuara të pajisura me UM si dhe gratë e divorcuara të identifikuara në nevojë janë ndihmuar me pako ushqimore nga bashkia Korçë.
- Kjo bashki nuk ka patur asnjë rast të trajtimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje të cilat e kanë patur të nevojshme dhe të detyrueshme akomodimin pranë Strehëzës Kombëtare, përgjatë periudhës janar-prill.

Tabela 13. Të dhëna nga MKR Korçë

Muaji	UMM
Janar	2
Shkurt	2
Mars	3
Prill	2

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Korçë

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në 4-mujorin e parë të 2020 janë paraqitur gjithsej 31 kërkesa për Urdhër Mbrojtje (UM) dhe Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), nga të cilat:

- 15 pranuar
- 16 pushuar

Tabela 14. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

Përshkrimi	Periudha Kohore 2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	0	3	1	1
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	4	6	4	3
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4	1	3	0	1

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

Në lidhje me gjykimet penale dhunë në familje janë gjykuar dhe shpallur vendime për nenin 130/a, 1,2,3,4 të Kodit Penal, në total 5 vendime për UM dhe 17 vendime për UMM.

Të dhëna nga Drejtoria Vendore të Policisë Korçë

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 31 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 31 individë, ku 21 prej viktimave ishin gra/vajza. 26 ishin gjithsej kërkesat për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM).

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 4 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku u arrestuan 6 agresorë.

Tabela 15. Të dhëna për dhunën në familje Korçë

Përshkrimi	Komisariati Korçë
Evidentuar	31
Të dëmtuar gjithsej	31
Prej tyre gra/vajza	21
K-P.U. Mbrojtje	26
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	4
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	6
Ndaluar për 130/a	0
Gjendje të Lirë për 130/a	0
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë policisë vendore bashkia Korçë, për muajin mars 2020 janë paraqitur 7 kërkesa për Urdhra Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 6 kërkesa të tilla. Por në asnjë rast nuk u evidentuan shkelje të Urdhrave të Mbrojtjes. Një rritje pasqyrohet për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Korçë nuk evidentoi asnjë rast të kësaj vepre penale, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale ishte 2 dhe u arrestua 1 agresor.

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Lezhë

- Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, duke filluar nga 9 mars dhe në vijim stafi i bashkisë Lezhë është paraqitur në punë çdo ditë edhe gjatë fundjavës kur ka qenë e nevojshme.
- Koordinatorja ka vijuar me përmbushjen e detyrave që asaj i takojnë sipas pozicionit por përveç rasteve të dhunës në familje, një vemëndje të shtuar ajo i ka kushtuar dhe vlerësimin të kategorive në nevojë. Është bërë identifikimi i familjeve në nevojë si dhe shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjieno-sanitare, duke sjellë kështu që një pjesë e mirë e kohës të mbueshet me ndihmën e dhënë në terren.
- Gjatë periudhës janar – prill 2020, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) Lezhë ka trajtuar vetëm 4 raste të dhunës në familje të pajisura me Urdhra Mbrojtje (UM) dhe Urdhra të Menjehershëm të Mbrojtjes (UMM).
 - 3 raste të dhunës në familje janë lajmëruar në polici dhe kjo e fundit ka informuar MKR-në.
 - Dy prej viktimave janë larguar nga shtëpia bashkëshortore dhe janë aktualisht pranë familjeve të tyre.
 - Rasti i trete është në shtëpinë e saj, duke qenë se dhunuesi është arrestuar nga policia.
- Gjatë muajit prill është trajtuar vetëm 1 rast dhune në familje, e cila kishte nevojë për ndjekje në kuadër të nevojës për shërbime të ndryshme. Sipas MKR Lezhë, në të gjitha rastet viktimat e dhunës në familje, në varësi të nevojave të tyre kanë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga bashkia.
- Marrëdhënia me gjykatën ka vazhduar të jetë korrekte ku urdhrat e mbrojtjes dorëzohen në bazë të afatit që kanë për t'u dërguar. Pavarësisht vështirësisë si pasojë e situatës, gjatë periudhës mars - prill dërgimi i UMM-ve dhe UM-ve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor kanë qenë i rregullt.
- Bashkia e Lezhës ka ofruar 5056 pako ushqimore dhe sanitare për familjet në nevojë, ku nga viktimat e dhunës në familje janë trajtuar me këtë ndihmë 25 raste me shpërndarje periodike prej 2 javësh.
- Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 Bashkia Lezhë ka gjetur mënyra alternative për t'u gjendur pranë rasteve të dhunës në familje duke përfshirë në pakot ushqimore fletushka me informacion sesi të mbrohen në rast abuzimi dhe numrat e telefonit të vendosur në dispozicion për ndihmë. Në faqen zyrtare Shërbimet Sociale Bashkia Lezhë gjithashtu janë shpërndarë shumë mesazhe sensibilizuese. Publikimi i aplikacionit "GJEJZA" si dhe sjellja dhe njëherë në vemendje përmes publikimit të numrave ku gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje mund të drejtohen për ndihmë.¹⁶
- Sa i përket trajtimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje të cilat e kanë patur të nevojshme dhe të detyrueshme akomodimin pranë Strehëzës Kombëtare, përgjatë periudhës janar-prill kjo bashki nuk ka patur asnjë rast.

Tabela 16. Të dhëna nga MKR Lezhë

Muaji	UMM
Janar	1
Shkurt	2
Mars	0
Prill	1

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Lezhë

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në 4-mujorin e parë të 2020 janë paraqitur gjithsej 58 kërkesa për Urdhër të Menjehershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM).

16 https://www.facebook.com/bashkialezhesherbimetsociale/?epa=SEARCH_BOX

Gjatë kësaj periudhe kohe trendi ka qënë në rritje në krahasim me atë të një viti më parë.

- Në muajin janar: Janë shpallur 28 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin shkurt: Janë shpallur 15 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin mars: Janë shpallur 8 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin prill: Janë shpallur 7 vendime me objekt UM dhe UMM.

Tabela 17. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

Përshkrimi	Periudha Kohore 2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	8	1	3	3
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	10	10	2	4
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4	5	4	3	2

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Lezhë

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë komisarariatit qendër të bashkisë Lezhë për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 33 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 34 individë. (*Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar*), ku 26 prej viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 26 ishin gjithsej kërkesat për UM/UMM dhe nuk kishte asnjë rast shkelje të këtyre urdhrave. Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 7 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 3 agresorë, 1 agresorë është ndaluar, 2 prej tyre janë në gjendje të lirë dhe 1 është në kërkim.

Tabela 18. Të dhëna për dhunën në familje Lezhë

Përshkrimi	Komisariati Lezhë
Evidentuar	33
Të dëmtuar gjithsej	34
Prej tyre gra/vajza	26
Kërkesë për U.Mbrojtje	26
Shkelje U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	7
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	3
Ndaluar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	2
Në kërkim për 130/a	1
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë policisë vendore bashkia Lezhë, për muajin mars 2020 janë paraqitur 3 kërkesa për Urdhër Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 6 kërkesa të tilla, duke patur dyfishim të kërkesës për ndihmë. Por në këta dy muaj të mbylljes pandemike, nuk u evidentua asnjë rastet i shkeljes së UM/UMM. Në vijim përgjatë muajve mars dhe prill, u evidentua nga 1 rast për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a të kodit, ku në muajin mars u arrestua një aggressor ndërsa në muajin prill nuk kishte arrestime.

BASHKIA POGRADEC

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Pogradec

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) pranë bashkisë Pogradec ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Për periudhën janar-mars (deri në fillimin e pandemisë) është ndjekur procedura normale e funksionimit të MKR-së.

- Janë organizuar takime të rregullta me aktorët e mekanizmit, takime individuale, si dhe janë organizuar 3 takime të Grupit Teknik Nderdisiplinor (GTN) gjatë periudhës janar -prill dhe 1 takim online gjatë mbylljes nga pandemia, për të diskutuar mbi rastet e referuara dhe mbështetjen e nevojave të tyre.
- Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje i bashkisë Pogradec gjatë periudhës së pandemisë ka mbajtur kontakte të rregullta me të gjitha rastet e dhunës në familje për çdo problem që kanë pasur, dhe në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara atyre u është ofruar ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike. Janë në pritje 200 pako për të mbështetur familjet në nevojë, përfshirë dhe gratë e dhunuara, pasi në këtë periudhë janë duke përjetuar izolim të dyfishtë.
- Përvec 17 rasteve të reja të viktimave të dhunës të identifikuara gjatë periudhës janar- prill 2020 janë mbështetur nga bashkia me pako ushqimore dhe dyfishim të ndihmës ekonomike edhe 34 raste të tjera të mbartura nga viti paraardhës.
- Koordinatori Vendor në Bashkinë Pogradec i ka kryer funksionet e tij të plota, me orar të reduktuar të paraqitjes në zyrë. Ai është përfshirë në aktivitete të tjera mbështetëse të organizuara nga shërbimi social komunitar i bashkisë për shpërndarjen e paketave ushqimore dhe atyre higjienike për familjet në nevojë.
- Komunikimi midis anëtarëve të MKR Pogradec ka qenë i vazhdueshëm. Nuk ka pasur raste që të jenë neglizhuar për shqetësimet që ata kanë përcjellë. Sfidat dhe vështirësitë kanë ardhur si pasojë e largësive të Njësive Administrative (NJA) dhe kushtet e vështira për ti aksesuar ato në kushtet e pandemisë.
- Përsa i përket trajtimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje të cilat e kanë patur të nevojshme dhe të detyrueshme akomodimin pranë Strehzës Kombëtare, përgjatë periudhës janar-prill kjo bashki nuk ka pas asnjë rast të strehuar në strehëzën kombëtare.
- Gjatë periudhës janar-prill 2020 nga MKR i Bashkisë Pogradec janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 17 raste të dhunës në familje, nga këto 8 raste me Urdhër të Menjëhershëm të Mbrotjes (UMM), 9 raste me Urdhër Mbrojtje (UM). Gjithashtu mbështetja dhe monitorimi ka vazhduar edhe për 34 raste të mbartura nga viti 2019, të cilave nuk i ka mbaruar afati kohor i mbrojtjes nga UM.

Tabela 19. Të dhëna nga MKR Pogradec

Muaji	UMM
Janar	6
Shkurt	2
Mars	4
Prill	2

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Gjatë periudhës janar – prill 2020 dërgimi i UMM/UM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka qenë i rregullt edhe në kohë si me poshtë paraqitur. Numri i padive të depozituara në Gjykatë me objekt: Lëshim i UM/UMM për muajin prill 2020 është 1 për të cilin ka përfunduar gjykimi. Lidhur me rastet e dhunës në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4 në gjykatë për muajin

prill 2020 janë paraqitur 2 kërkesa për caktim mase sigurimi për nenit 130/a/4, dhe 4 kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq sipas nenit 130/a/1 (dy kërkesa) dhe 130/a/4 (dy kërkesa). Për periudhën e pandemisë bashkëpunimi midis gjykatës dhe antarëve të MKR-së, koordinatori vendor ka qenë shumë cilësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka pranuar gjatë periudhës së Marsit dy kërkesa për UM. Në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale (MSHMS) i është kërkuar gjykatës që në këtë periudhë pandemie të jepen menjëherë UM duke anashkaluar UMM për shkak të kufizimit të lëvizjes.

Tabela 20. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Pogradec

Përshkrimi	Periudha Kohore 2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	3	1	2	1
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	3	1	2	0
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4	0	0	0	10

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Pogradec

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Pogradec për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 6 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 7 individë, ku 5 prej viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 4 ishin gjithsej kërkesat për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM).

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 2 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku u arrestuan 2 agresorë.

Tabela 21. Të dhëna për dhunën në familje Pogradec

Përshkrimi	Komisariati Pogradec
Evidentuar	6
Të dëmtuar gjithsej	7
Prej tyre gra/vajza	5
K-P.U. Mbrojtje	4
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	2
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	2
Ndaluar për 130/a	0
Gjendje të Lirë për 130/a	0
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë Policisë Vendore bashkia Pogradec, për muajin mars 2020 janë paraqitur 2 kërkesa për Urdhra Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentua vetëm 1 kërkesë e tillë, duke mos evidentuar asnjë rast shkelje të UM/UMM. Një rritje e vogël pasqyrohet për veprën penale "Dhunë në familje" sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Pogradec evidentoi 1 rast të kësaj vepre penale duke arrestuar agresorin, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale u dyfishua duke regjistruar 2 raste të tilla ku u arrestua 1 agresor.

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Sarandë

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) pranë Bashkisë Sarandë përgjatë periudhës së mbylljes pandemike, nuk ka organizuar takime ballë për ballë dhe as on-line dhe komunikimi mes anëtarëve gjatë kësaj periudhe ose ka munguar ose është shumë i vakët.
- Koordinatorja vendore pranë bashkisë Sarandë ka punuar rregullisht edhe gjatë kohës së mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19, por duke qenë se ajo ka edhe profil punonjëse sociale, ka qenë e nevojshme prania e saj për të ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, fëmijëve apo kategorive të tjera të cilat bashkia Sarandë i ka nën patronazh.
- Komunikimet me Specialisët e Policisë së Zonës (SPZ) nga ana e koordinatorës apo e mekanizmit në terësi janë shumë të rralla sidomos gjatë periudhës mars-prill.
- Përgjatë muajve mars dhe prill ky mekanizëm nuk ka trajtuar asnjë rast të dhunë në familje, ndërkohë që 3 raste janë trajtuar nga organizatat e shoqërisë civile.
- UM dhe UMM janë dërguar në mënyrë të rregullt nga gjykata, por ndjekja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje nuk është kryer në mënyrë të rregullt. Kjo, sepse edhe policia edhe gjykata plotësimin e formularëve përkatës nuk e bëjnë të plotë, duke dërguar UM/UMM pa adresa të sakta dhe pa numra telefoni për kontakt. Kjo është një problematikë e cila vijon ndër vite dhe nuk ka patur një ndryshim apo përmirësim të kësaj shtate as përgjatë periudhës pandemike.
- Për muajt janar dhe shkurt, koordinatorja vendore ka marrë njoftim nga gjykata për 8 raste të pajisura me UM/UMM por asnjëri prej tyre nuk është ndjekur nga ky mekanizëm.
- Gjatë muajit prill vetëm 1 rast i ri (viktimë e dhunës në familje) ka përfituar Ndhimë Ekonomike të dyfishuar por që nuk është ndjekur më gjatë nga mekanizmi i referimit pranë kësaj gjykate.
- Bashkia Sarandë, gjatë këtij viti nuk ka patur trend të rritjes së rasteve të dhunës në familje pranë kësaj bashkie. Vijon përsëritja e rasteve po njësoj si një vit më parë në të njëjtën periudhë.

Statistika nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në 4-mujorin e parë të 2020 janë pranuar gjithsej 24 kërkesa për UM dhe UMM.

Në lidhje gjykimet penale Dhunë në Familje janë gjykuar dhe shpallur vendime për nenin 130/a, 1,2,3,4 të Kodit Penal në total 5 vendime nga të cilat 3 agresorë janë dënuar, 1 çështje është në proces dhe 1 rast i është kthyer Prokurorisë.

Tabela 22. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë

Periudha Kohore 2020				
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje	3	2	2	3
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	3	8	0	3

Burimi: Koordinatorja Vendore Sarandë

Të dhëna nga Drejtoria vendore e Policisë Sarandë

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Sarandë për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 10 raste dhunë në familje ku 8 prej tyre ishin gra/vajza. Në vijim, 8 ishin gjithsej kërkesat për UM dhe UMM dhe nuk janë evidentuar raste të shkeljes së këtyre urdhrave.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, u evidentua 1 veprë penale e dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku u ndalua 1 agresor. Tabela vijuese pasqyron në detaje statistikën në lidhje me rastet e dhunës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Sarandë.

Tabela 23. Të dhëna për dhunën në familje Sarandë

Përshkrimi	Komisariati Sarandë
Evidentuar	10
Të dëmtuar gjithsej	10
Prej tyre gra/vajza	8
K-P.U. Mbrojtje	8
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	1
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	0
Ndalar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	0
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Pranë policisë vendore bashkia Sarandë, për muajin mars 2020 nuk janë paraqitur kërkesa për Urdhra Mbrojtje, si dhe nuk u evidentua asnjë rast i shkeljes së UM/UMM. Ndërkohë që në muajin prill u paraqitën 4 kërkesa për UM por asnjë rast i shkeljes së UM nuk u evidentua. Një rritje sado e vogël pasqyrohet edhe për veprën penale "Dhunë në familje" sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Sarandë nuk regjistroi asnjë rast të kësaj veprë penale, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë veprë penale regjistroi 1 të tillë dhe u procedua me arrestimin e tij.

BASHKIA SHKODËR

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Shkodër

- Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) pranë bashkisë Shkodër ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Komunikimi është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me Specialistët e Policisë së Zonës (SPZ), me të cilët bashkëpunimi ka qënë shumë i ngushtë.
- Përgjatë periudhës janar-prill janë trajtuar dhe monitoruar edhe urdhërat e tjerë të mbrojtjes që janë në fuqi nga muajt e mëparshëm. Në total janë menaxhuar dhe trajtuar 36 raste.
- Përgjatë kësaj periudhe (9 mars – vijim) koordinatori ka vazhduar ushtrimin e të gjithë detyrave funksionale që i paracakton pozicioni. Në varësi të nevojave të paraqitura pranë kësaj bashkie përveç rasteve të dhunës në familje, ajo është angazhuar edhe në identifikimin dhe vlerësimin e kategorive në nevojë (për identifikimin e familjeve në nevojë, ndarjen pakove ushqimore etj të ngjashme).
- Bashkia Shkodër në varësi të nevojave të paraqitura ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme me pako ushqimore dhe higjieno-sanitare 7 raste, viktimat të dhunës në familje.
- Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë periudhës janar-prill 2020.
- Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 janë shpërndarë postera me informacionin dhe kontaktet e nevojshme, për të sensibilizuar komunitetin për të mos pranuar dhunë në familje si dhe informacionet ku duhet të kontaktojnë në rast dhune.¹⁷
- Në faqen zyrtare të facebook të Drejtorisë së Shërbimeve, Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është publikuar rregullisht çdo aktivitet sensibilizues i organizuar nga Bashkia Shkodër për parandalimin e dhunës.
- Gjatë periudhës janar – prill 2020, Mekanizmi i Referimit Shkodër ka trajtuar 14 raste të dhunës në familje të pajisura me Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM).
- Gjithashtu përgjatë muajit prill janë vlerësuar edhe tre raste me Urdhër Mbrojtje të pajisura prej vitit 2019 të cilët janë trajtuar me ndihmë ekonomike pranë rajoneve përkatëse administrative dhe nuk paraqesin shqetësime nga dhunuesit e tyre.

Tabela 24. Të dhëna nga MKR Shkodër

Muaji	UM dhe UMM
Janar	5
Shkurt	5
Mars	3
Prill	1

Burimi: Bashkia Shkodër

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në periudhën kohore janar – prill 2020 janë paraqitur gjithsej 38 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM), nga të cilat janë shpallur 40 (duke qenë se 2 çështje kanë qenë të mbartuara nga vitit 2019).

¹⁷ <https://www.facebook.com/207655856280284/posts/1087030361676158/> <https://www.facebook.com/207655856280284/posts/1064571133922081/>

- Në muajin janar: Janë shpallur 8 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin shkurt: Janë shpallur 16 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin mars: Janë shpallur 9 vendime me objekt UM dhe UMM;
- Në muajin prill: Janë shpallur 7 vendime me objekt UM dhe UMM.

Ne tabelën vijuese gjenden të detajuara vendimet e kësaj gjykate për periudhën kohore janar – prill 2020.

Tabela 25. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Periudha Kohore 2020				
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Urdhër Mbrojtje				
Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje	8	16	9	7
Vepra Penale 130/a Paragrafi 1,2,3,4	17			

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Në lidhje gjykimet penale Dhunë në Familje janë gjykuar dhe shpallur vendime për nenin 130/a, 1,2,3,4 të Kodit Penal në total 17 vendime ndër të cilat:

- 14 vendime fajësie
- 2 vendime pafajësie dhe
- 1 vendim pushimi

Nga të gjykuarit për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a'1, 2, 3, 4 të Kodit Penal është vendosur:

- 14 të dënuar (13 të rritur + 1 i mitur)
- 2 të pafajshëm
- Dhe për 1 të gjykuar është vendosur pushimi

Të dhënat e mësipërme rakordojnë sipas periudhës janar – mars 2020, duke qenë se gjatë muajit prill nuk janë gjykuar çështje themeli penale me bazë ligjore nenin e sipërcituar.

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Shkodër

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër të bashkisë Shkodër për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 18 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 19 individë (*Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar*). 13 prej viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 9 ishin gjithsej kërkesat për UM/UMM dhe nuk kishte asnjë rast shkelje të këtyre urdhrave.

Gjatë 3 muajit të parë të vitit 2020, 7 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 4 agresorë, u ndalua 1, 2 prej tyre janë në gjendje të lirë dhe 1 është në kërkim.

Tabela 26. Të dhëna për dhunën në familje Shkodër

Përshkrimi	Komisariati Shkodër
Evidentuar	18
Të dëmtuar gjithsej	19
Prej tyre gra/vajza	13
K-P.U. Mbrojtje	9
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	7
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	4
Ndaluar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	2
Në kërkim për 130/a	1
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nga të dhënat e fundit të përfituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pranë policisë vendore bashkia Shkodër, për muajin mars 2020 janë paraqitur 4 kërkesa për Urdhra Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill u evidentuan 8 kërkesa të tilla, duke patur një rritje të kërkesës për ndihmë me 100 %. Gjatë mbylljes për shkak të pandemisë pranë kësaj bashkie nuk ka patur asnjë shkelje të UM/UMM. Ndërkohë që nuk ka diferenca të mëdha por rënie të rasteve, në lidhje me veprën penale "Dhunë në familje" sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Shkodër evidentoi 2 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 1 agresor, ndërkohë që në muajin prill u evidentua vetëm 1 rast që u shoqërua me arrestimin e agresorit.

BASHKIA VLORË

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Vlorë

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) pranë bashkisë Vlorë ka operuar dhe funksionuar në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme edhe pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë COVID-19.
- Në mënyrë të vazhdueshme "Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes" (UMM-të) prej gjykatës, I janë drejtuar zyrës së Shërbimit Social.
- Çdo rast dhune i paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatores së dhunës dhe viktimës.
- Gjatë periudhës 9 mars - fund prilli, koordinatorja e Njesisë së Dhunës në Familje pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ka vijuar punën çdo ditë ku krahas trajtimit të rasteve të dhunës në familje, janë menaxhuar gjithashtu me staf të reduktuar edhe rastet e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, pozicion i cili prej fillimit të muajit shkurt vijon ende vakant.
- Për muajin mars 2020, në bazë të Urdhrit nr.92/4 datë 27/03/2020, individët në nevojë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike përfituan dyfish pagesën e ndihmës ekonomike dhe kjo jo vetëm për skemën e sistemit dixhital dhe fondit të kushtëzuar 6% që financohet nga buxheti i shtetit por u trajtuan edhe familjet të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë Vlorë.
- Në skemën e ndihmës ekonomike përfshihet edhe kategoria e viktimave të dhunës në familje të pajisura me UM. Një prej masave të marra në mënyrë urgjente nga institucioni i bashkisë në përputhje me ligjin nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", është edhe trajtimi i përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike për të gjitha kategoritë në nevojë, në ofrimin e paketave ushqimore në mënyrë të vazhdueshme për këta përfitues.
- Gjatë periudhës janar-mars 2020 janë trajtuar në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kliniken ligjore të QPS "Vatra" dhe me Policinë e qarkut Vlorë në total 48 raste dhune në familje si kërkesëpadi të përpiluara pranë Policisë së qarkut Vlorë. Nga këto 3 raste janë "Urdhëra Mbrojtje" (UM) dhe 45 raste UMM.
- Koordinatorja vendore e dhunës në familje pranë bashkisë Vlorë, për periudhën janar-prill 2020, ka trajtuar 23 raste në total të paraqitura me UMM nga gjykata, përkatësisht 7 raste në muajin janar, 5 raste në muajin shkurt, 10 raste në muajin mars dhe 1 rast në muajin prill.
- Në muajin janar është menaxhuar edhe 1 rast dhune në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisiplinar dhe në koordinim të përmiresuar mes aktoreve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat përkatëse për mbështetjen e plotë të viktimës.
- Gjithashtu përgjatë muajit prill janë vlerësuar edhe tre rastet me Urdhër Mbrojtje të pajisur më UM prej vitit 2019 të cilët janë trajtuar me ndihmë ekonomike pranë rajoneve përkatëse administrative dhe nuk paraqesin shqetësime nga dhunuesit e tyre.

Tabela 27. Të dhëna nga MKR Vlorë

Muaji	UMM
Janar	7
Shkurt	5
Mars	10
Prill	1

Burimi: Bashkia Vlorë

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Vlorë

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, janar - prill 2020 janë paraqitur gjithsej 59 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) ku u pranuan 43 prej tyre. Ne tabelën vijuese gjenden të detajuara vendimet e kësaj gjykate për periudhën kohore janar – prill 2020.

Tabela 28. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

Periudha	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Janar – prill	4	55	59	43	6	7	0

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Vlorë

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 59 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 59 individë. Nga ky numër, 45 rasteve të viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 38 ishin gjithsej kërkesat për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) dhe nuk kishte asnjë rast shkelje të këtyre urdhrave.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2020, 18 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 7 agresorë, u ndaluan 2 dhe 9 prej tyre janë në gjendje të lirë.

Tabela 29. Të dhëna për dhunën në familje Vlorë

Përshkrimi	Komisariati Vlorë
Evidentuar	59
Të dëmtuar gjithsej	59
Prej tyre gra/vajza	45
K-P.U. Mbrojtje	38
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	18
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	7
Ndaluar për 130/a	2
Gjendje të Lirë për 130/a	9
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pranë policisë vendore bashkia Vlorë, për muajin mars 2020 janë paraqitur 14 kërkesa për Urdhra Mbrojtje, ndërkohë që gjatë muajit prill ky numër u ul në 6 kërkesa të tilla, gjithashtu pranë policisë së kësaj bashkie nuk kishte asnjë rast të shkeljes së UM/UM gjatë muajve mars dhe prill. Një trend zbritës paraqitet edhe për rastet e veprës penale "Dhunë në familje" sipas nenit 130/a¹¹ të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19.

Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Vlorë evidentoi 10 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 3 agresorë, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale ishte vetëm 2 raste të tilla, por që një asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte të arrestuar.

Gjetje nga puna e MKR-së Bashkia Tiranë

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë Bashkisë Tiranë (MKR-Tiranë) ka gjetur rrugët dhe mënyrat e përshtatshme për t'iu ardhur në ndihmë të gjitha rasteve të referuara të dhunës në familje, pavarësisht situatës së distancimit social përgjatë periudhës pandemike COVID-19,
- Për periudhën janar-prill 2020, MKR-Tiranë ka organizuar 2 mbledhje fizike të Grupi Teknik Ndërinstitucional (GTN), me pjesëmarrjen e pjesës më të madhe të anëtarëve të Mekanizmit, mbledhje këto të organizuara në muajt janar dhe shkurt, dhe në periudhën e pandemisë, përgjatë muajve mars dhe prill, koordinatores ka qenë vazhdimisht në komunikime online me anëtarët e GTN-së me anë të postës elektronike dhe telefonit për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Në javën e parë të muajit mars u planifikua mbledhja e Komitetit Drejtues për datën 30 mars 2020, mirëpo për shkak të situatës Pandemike të COVID-19 dhe distancimit social mbledhja nuk u realizua. Njoftimi për Mbledhjen e Komitetit Drejtues do të bëhet në një moment të dytë pasi situata të jetë stabilizuar.
- Gjatë periudhës së mbylljes për shkak të virusit, MKR-Tiranë ka organizuar një sesion informues online me studentë të vitit të dytë të Administrimit dhe Politikave Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale.
- Në bazë të udhëzimeve të Ministrisë për trajtimin e rasteve të dhunës në situatën e pandemisë Covid-19, rastet janë lejuar që të strehohen pranë Strehëzës Kombëtare duke iu nënshtruar karantinimit 14 ditor në një dhomë të veçantë bashkë me fëmijët shoqërues.
- Përtëqenë samë pranë viktimave të dhunës në familje dhe rasteve, përveç informimit për Linjën e Këshillimit 24 orë është lënë në dispozicion dhe numri i Koordinatorës Vendore pranë Komisarivateve të Policisë për të asistuar gjatë dëshmimeve apo plotësimeve të urdhërave të mbrojtjes.
- Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga Mekanizmi I Referimit Tiranë janë asistuar në plotësimin e nevojave të tyre, në pagesën e qerasë në bashkëpunim me organizata bashkëpunëtore për 2 raste që e kanë patur të pamundur si dhe janë asistuar në aplikimin për përfitimin e bonusit të qerasë nga program i Strehimit Social pranë Bashkisë Tiranë, në dhënien e paketave ushqimore dhe higjienike 2-3 herë për secilin rast (të gjitha rastet e trajtuara nga ky mekanizëm) dhe që nga muaji mars sipas urdhërit të qeverisë është dyfishuar ndihma ekonomike për këtë kategori përfituesish.
- Në periudhën janar – prill 2020, janë trajtuar 42 raste të dhunës në familje gjatë mbledhjeve të GTN-së, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Qendrat Sociale. Këto raste, dhe të tjera, janë asistuar gjatë periudhës së izolimit 2-3 herë me paketa ushqimore dhe higjienike.
- Gjatë periudhës janar – prill 2020, 407 viktima të dhunës në familje kanë përfituar ndihmë ekonomike prej 3000 lekësh, nga pajisja me Urdhër mbrojtje në 24 njësitë administrative të Tiranës.

Tabela 30. Të dhëna nga MKR Tiranë

Muaji	UM/UMM
Janar	8
Shkurt	8
Mars	16
Prill	20

Burimi: Bashkia Tiranë

- Denoncimet dhe kërkesat për pajisjen me Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) në Komisaritet e Policisë kanë qenë më të larta sesa kërkesat drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, por krahasuar me kërkesat pranë Komisariateve të Policisë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë në një shifër më të ulët.
- Nga ana tjetër rastet që telefonojnë pranë Linjës Kombëtare të Këshillimit kanë patur një rritje me rreth 30% të numrit të telefonatave të marra, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në javën e parë pas vendosjes së karantinës (16 - 22 Mars), numri i telefonatave ka pësuar një rënie, për t'u rritur më pas gjatë javës së fundit të muajit mars dhe gjatë muajit prill. Telefonatat kanë qenë kryesisht nga gra dhe vajza, viktimat dhe të mbijetuarat të dhunës në familje, situata e të cilave është rënduar që pas vendosjes së karantinës për shkak të izolimit të detyruar në shtëpi së bashku me dhunuesit. Problematikat kryesore të telefonueseve, përveç dhunës, kanë qenë të natyrës socio-ekonomike dhe gjithashtu ka patur raportime të shumta në lidhje me ankthin dhe depresionin e shkaktuar nga izolimi.
- Koordinatorja vendore pranë kësaj bashkie ka punuar me kohë të plotë dhe pa ndërpererje, por ajo është angazhuar edhe me detyra të tjera që nuk i përkasin profilit, duke shpenzuar një kohë të madhe në terren në ndihmë të familjeve në nevojë për shpërndarje pakosh ushqimore apo pjesë e grupeve të patronazhit për banorët e moshës së tretë të kësaj bashkie.
- Për shkak të situatës së pandemisë institucionet shtetërore lokale janë fokusuar tërësisht në zbatimin e rregullave të izolimit nga popullsia dhe mbështetjen me ndihma të kategorive në nevojë duke mos u fokusuar mjaftueshëm çështjeve të dhunës ose duke u mjaftuar vetëm me ndihmë në pako ushqimore, higjieno-sanitare ndaj tyre ose këshillime online. Gjithashtu e vetmja ndihmë që nuk është prekur dhe ka vijuar në mënyrë të rregullt është pagesa për UM/UMM me 3000 lekë e dyfishuar sipas urdhrit të qeverisë shqiptare pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore.
- Nuk ka një informacion të qartë nëse sistemi online REVALB është përdorur apo jo gjatë kësaj periudhe dhe nëse është përdorur, nuk ka informacion për mirëfunksionimin e tij.
- Bashkia e Tiranës ishte një nga bashkitë e para e cila u trajnuar për protokollin e përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në lidhje me funksionimin e MKR në kohë pandemie dhe mbledhja e fundit e cila u organizua online si asnjëherë tjetër në 4 vite kishte prezentë të gjithë anëtarët e Grupit Teknik Ndërdisciplinar, drejtues institucionesh pjesë e MKR si dhe përfaqësues të Njësie Administrative apo/dhe SPZ të zonave.

Të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Sipas të dhënave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën kohore janar – prill 2020 janë paraqitur gjithsej 243 kërkesa për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM), nga të cilat janë pranuar 155. Në tabelën vijuese gjenden të detajuara vendimet e kësaj gjykate për periudhën kohore janar – prill 2020.

Tabela 31. Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Periudha Kohore	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjyqimit	Rrëzimi i kërkesës
Janar	12	54	66	41	22	6
Shkurt	14	57	71	40	21	9
Mars	9	42	51	23	16	1
Prill	2	53	55	51	20	9
TOTAL	37	206	243	155	79	25

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në lidhje gjykimet penale Dhunë në Familje gjatë periudhës janar – prill 2020, janë paraqitur pranë kësaj gjykate 72 raste të reja sipas nenit 130/a, 1,2,3,4. Janë shpallur me vendim fajësie 95 raste. Statistikat e përfituara nga faqja zyrtare e kësaj gjykate përveç rasteve të reja, nuk i kanë të ndarë edhe vendimet, ndaj shifra me vendim fajësie përfshin edhe vendimet e dhëna për rastet e mbartura.

Të dhëna nga Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për periudhën kohore janar – mars 2020, janë evidentuar gjithsej 239 raste dhunë në familje, ku të dëmtuar gjithsej ishin 259 individë.¹⁸ Nga ky numër, 195 prej viktimave të dhunës në familje ishin gra/vajza. Ndërkohë që 120 ishin gjithsej kërkesat për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM) dhe 7 ishin rastet shkeljes së këtyre urdhrave. Gjatë 3 muajve të parë të vitit 2020, 94 ishin veprat penale të dhunës në familje sipas Nenit 130/a, ku arrestuan 41 agresorë, u ndaluan 13 agresorë, 38 prej tyre janë në gjendje të lirë dhe 8 agresorë janë në kërkim. Statistika të hollësishme të ndara sipas komisariateve të bashkisë Tiranë gjenden në tabelën vijuese.

Pranë policisë vendore bashkia Tiranë, për muajin mars 2020 janë paraqitur 34 kërkesa për Urdhër Mbrojtje, dhe po 34 kërkesa për UM ka patur edhe për muajin prill. Ndërkohë që në muajin mars u evidentuan 5 raste shkelje të UM/UMM, gjatë muajit prill ky fenomen u ul në vetëm një rast. Një ulje e trendit pasqyrohet edhe për veprën penale “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a të kodit penal në dy muajt e parë të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin mars, policia vendore e bashkisë Tiranë evidentoi 29 raste të kësaj vepre penale duke arrestuar 13 agresorë, ndërkohë që në muajin prill numri i evidentuar i agresorëve për këtë vepër penale ishte 20, ku u arrestuan 11 dhunues.

¹⁸ Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar

Tabela 32. Të dhëna për dhunën në familje Tiranë

Përshkrimi	Komisariati Vlorë
Evidentuar	59
Të dëmtuar gjithsej	59
Prej tyre gra/vajza	45
K-P.U. Mbrojtje	38
Sh.U. Mbrojtjes	0
V. P. Neni 130/a	18
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	7
Ndaluar për 130/a	2
Gjendje të Lirë për 130/a	9
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhëna nga institucione të tjera

Instituti i Mjekësisë Ligjore

Gjatë periudhës kohore janar - prill 2020, pranë këtij institute janë paraqitur dhe trajtuar 29 raste në total, të ndara si vijon sipas muajve: janar 4 raste, shkurt 8 raste, mars 9 raste dhe në muajin prill janë paraqitur dhe trajtuar 8 raste.

Zyra Përmbartimore Tiranë

Gjatë muajve janar - prill 2020, pranë Zyrës së Përmbartimit Tiranë janë regjistruar 2 raste me objekt "Urdhër Mbrojtje", specifikisht 1 raste në muajin shkurt dhe 1 rast në muajin prill.

TË DHËNA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT

Që nga data 9 Mars, është miratuar një protokoll i posaçëm në lidhje me Dhunën në Familje, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe gjithashtu paralelisht, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka lëshuar një letër të posaçme ndaj drejtorive vendore drejtuar Specialistëve të Policisë së Zonës (SPZ) dhe personave përgjegjës, për të ushtuar kontrole periodike të zonave ku ka sinjalizime të dhunës në familje. Megjithëse ky është një urdhër i rëndësishëm dhe i domosdoshëm jo vetëm në perioda krizash sic ishte COVID-19, nuk dihet zbatueshmëria e tij, pasi nuk ka një raport në lidhje me këtë.

Në rang Republike bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për periudhën e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19 në datat 11 mars - 18 maj 2020 janë evidentuar 655 raste të dhunës në familje, ose 273 raste më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ku janë evidentuar 928 raste. Janë kërkuar 391 kërkesë padi për urdhër mbrojtje për vitin 2020 ose 119 më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ku janë 510.

Sipas Nenit 130/a, janë proceduar penalisht 226, ose 6 më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ku janë proceduar penalisht 220 persona. Gra të dëmtuara për vitin 2020 janë 455, ose 171 më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ku të dëmtuara gra ishin 626. Të arrestuar për vitin 2020 janë 79 persona krahasuar me vitin 2019 ku janë 86. Gjatë periudhës së pandemisë nuk ka patur asnjë vrasje krahasuar me të njëjten periudhë të 2019 ku ka patur 3 vrasje.

Pavarësisht kësaj, i jemi drejtuar me komunikim zyrtar Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për veprime të koordinuara institucionale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, në kushtet e pandemisë Covid-19".

Veprimtaria e organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar e lokal

Në kuadër të monitorimit të përgjigjes vendore kundër dhunës me bazë gjinore GADC bashkëpunoi me disa organizata aktive në nivel kombëtar dhe lokal.

Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra e Vajza

Tabela 34. Telefonatat e marra nga LKGV në mbarë vendin

Muaji	Telefonata	Ballë për Ballë
Janar	296	108
Shkurt	257	89
Mars	395	49
Prill	726	0

Burimi: Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra e Vajza

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza e themeluar në 1996, pas nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, operon që prej vitit 2016, Linjën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Shqipëri, përmes numrit të gjelbër 116117. Linja telefonike është e disponueshme 24 orë të ditës, 7 ditë të javës dhe është porta hyrëse për shumë gra dhe vajza të cilat përjetojnë dhunë. Një ekip i specializuar ofron këshillim psiko-social dhe ligjor dhe referim në shërbime të tjera më të specializuara.

Gjatë periudhës së karantinës për shkak të COVID-19, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza ka patur një rritje me rreth 30% të numrit të telefonatave të marra në muajin mars, ndërsa gjatë muajit prill janë pritur 60% telefonata më shumë se në prillin e vitit të kaluar. Telefonuesit kanë qenë kryesisht gra dhe vajza, të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, gra të moshuara por edhe njerez që jetojnë të vetmuar e pa përkrahje, situata e të cilëve ka parë një përkeqësim që pas vendosjes së karantinës. Problematikat kryesore të telefonuesve, përveç dhunës, kanë qenë të natyrës socio-ekonomike dhe gjithashtu raportime të shumta kanë ardhur në lidhje me ankthin dhe depresionin e shkaktuar nga izolimi.

Për rastet e telefonatave nga qyteti i Tiranës ka funksionuar Mekanizmi i Referimit pranë bashkisë Tiranë për refrimin e rasteve në insitucione më të specializuara, sipas nevojave të telefonuesve. Gjithashtu, një pjesë e telefonuesve nevojat e të cilëve për ushqime, mjekime dhe materiale higjienike janë vlerësuar si emergjente nga këshillueset e Linjës së Këshillimit, janë futur në listën e përfitueseve të bashkisë dhe kanë përfituar ndihmat që shpërndahen nga njësitë administrative.

Tabela 35. Telefonatat e marra nga LKGV sipas bashkive të monitoruara

Muaji	Durrës	Elbasan	Fier	Kamëz	Korçë	Lezhë	Pogradec	Sarandë	Shkodër	Vlorë	Tiranë
Mars	89	68	42	101	23	45	45	18	86	43	387
Prill	107	64	37	117	19	56	43	11	114	36	371

Burimi: Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra e Vajza

Qendra e Shërbimit Ligjor Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Kjo Qendër është inaguruar në datë 06.03.2020 pranë ambjentëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës e mbështetur nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, financuar nga Qeveria austriake përmes "Agjencisë Austriake për Zhvillim" (Austrian Development Agency) dhe zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare. Kjo Qendër ringrihet për të dytën herë në këtë Gjykatë dhe do të ofrojë ndihmë ligjore parësore dhe dytësore për komunitetet në nevojë duke synuar rritjen e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë.

Sipas të dhënave të para statistikore numri i qytetarëve që kanë përfitur shërbim ligjor falas nga momenti i hapjes 06.01.2020 - 02.03.20 është 69, duke mos u specifikuar se sa prej tyre janë raste të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ndërkohë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 nga ana e tyre janë ofruar shërbime ligjore falas për komunitetet në nevojë përmes komunikimit telefonik dhe është trajtuar më këshillim ligjor vetëm një grua e cila aktualisht ishte me urdhër mbrojtje dhe bashkëshorti i saj ndodhej i arrestuar.

Rrjeti "Sot për të Ardhmen"

"Sot për të Ardhmen" ka shtrirje kombëtare me programet e tij. Kjo qendër ofron:

- Mbështetje dhe këshillim ligjor për të mbijetuarat/it e dhunës në familje, veçanërisht për Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Mbrojtjes.
- Mbështetje psikosociale për të mbijetuarat/it e dhunës në familje.
- Linja telefonike 24 orëshe 0800 9888 pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje.

Për bashkinë Durrës përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19 QZHK "Sot për të Ardhmen" ka shpërndarë 14 postime sensibilizuese në rrjetin social Facebook¹⁹. Konkretisht postimet kanë qëllim informues për masat mbrojtëse ndaj Covid-19, qëllim sensibilizues për denoncimin e dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe qëllim edukues për aktivitetet krijuese që mund të zhvillohen në kushte shtëpie.

Gjatë periudhës mars – prill 2020 është ofruar këshillimi psikologjik nga psikologjia e qendrës për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre. Ky shërbim është ofruar çdo ditë nga e hëna në të premte në bazë të nevojave të rasteve, pas dates 10 mars ky shërbim është ofruar vetëm online nëpërmjet telefonit dhe faqes zyrtare në Facebook. Gjatë periudhës mars – prill 2020, nga shërbimi psikologjik kanë përfitur në total 46 gra dhe vajza.

QZHK "Sot për të Ardhmen" ka ofruar gjithashtu këshillim ligjor ballë për ballë dhe me telefon, si dhe përfaqësim e mbrojtje në gjykatë dhe prokurori. Në total gjatë muajve mars - prill janë asistuar me këshillim juridik 48 raste. Shoqata ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me antarët e Mekanizmit të Koordinimit të Referuar bashkia Durrës, 7 herë gjatë muajit mars për të bërë menaxhimin e nevojave të rasteve.

19 <https://www.facebook.com/albaniancommunitycentre/>

Për bashkinë Tiranë kjo qendër gjatë periudhës janar – prill 2020 ka trajtuar:

- 49 raste - gra dhe vajza viktime/ të mbijetuara të dhunës në familje përmes këshillimit psikologjik;
- Të ndara sipas muajve: në janar u trajtuan 6 raste, në shkurt 8 raste, në **mars 16 raste dhe gjatë muajit prill u trajtuan 19 raste.**
- 35 raste të reja janë trajtuar me këshillim online;
- Nëpërmjet linjës telefonike ka monitoruar rastet e mëparshme të asistuar me shërbim psikologjik e ligjor, nëse janë të riskuara nga dhuna apo edhe duke i'u qëndruar pranë me këshilla profesionale për ruajtjen e shëndetit mendor.

Shoqata "Gender, Paqe e Siguri"

Për bashkinë Durrës kjo shoqatë ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, bazuar në projektin "Qendra Sociale për Gra dhe Vajza" financuar nga AEEN/SIDA. Gjatë periudhës së mbylljes nga pandemia Covid-19 (9 mars-30 prill) kjo organizatë ka shpërndarë 20 postime sensibilizuese në rrjetin social Facebook²⁰.

Përgjatë kësaj periudhe Shoqata ka vazhduar ofrimin e shërbimeve duke vendosur në dispozicion dy numra kontakti të aksesueshëm përgjatë orarit 9:00 - 17:00 në numrat e kontaktit +355 69 208 9041; 042 400 652. Si dhe pritja e mesazheve përmes faqes zyrtare të facebook.

Organizata "Tjetër Vizion"

Gjate periudhës 4-mujore janar- prill 2020 **për bashkinë Elbasan** janë referuar dhe vetëreferuar në shoqatën "Tjetër Vizion" 56 raste të grave dhe vajzave me probleme sociale- ekonomike, ku 45% e tyre kanë patur probleme të dhunës në familje. Rasteve të referuara i'u është ofruar mbështetje psiko-sociale, 6 raste janë mbështetur me ndihmë ligjore nga avokatja e shoqatës si dhe pjesa më e madhe kanë marrë shërbimin falas të formimit profesional. 10-të prej këtyre nënave që punojnë kryesisht në fasoneri deri në orët e vona i'u është ofruar ndihma për femijët e tyre të moshës 3-10 vjeç në kopshtin alternativ ofruar nga shoqata në bashkëpunim me bashkinë Elbasan.

Ky shërbim ka funksionuar deri në datë 9 mars, ditë pas të cilës me vendim të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë është bërë mbyllja e shkollave dhe kopshteve. Kërkesa dominuese e të gjithë rasteve të grave dhe vajzave të mbështetura nga shoqata ka qenë mbështetja ekonomike, punësimi dhe strehimi. Janë mbështetur me vetëpunësim gjatë periudhës së mars-prillit 2020, 4 gra të cilat në kushte shtëpie kanë qepur maska dhe i'u është gjetur treg për shitje, duke gjeneruar të ardhura për familjet e tyre.

"Forumi i Gruas"

Në bashkinë Elbasan, gjatë periudhës 4 mujore janar- prill kjo organizatë ka pritur 242 telefonata për mbështetje të rasteve të grave dhe vajzave në nevojë dhe me histori dhune. (Theksojmë se këto telefonata janë regjistruar në nivel qarku.) Numri i telefonatave nuk tregon numrin e rasteve pasi një rast mund të ketë telefonuar dhjetra herë.

Qendra "Të drejtat e Njeriut në Demokraci"

Gjatë kësaj periudhe **për bashkinë Kamëz** Qendra "Të drejtat e Njeriut në Demokraci" (QDNJD) ka patur kontakt të vazhdueshëm me kliente të qendrës, të mbijetuara nga dhuna në familje por janë kontaktuar edhe nga raste të reja të cilat kanë denoncuar gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19, këto raste janë referuar nga komisariati numër 5 Kamëz.

20 <https://www.facebook.com/gruajapaqjasiguria>

- Nga data 10 mars dhe deri në fund të prillit janë kështu nëpërmjet telefonit 47 raste nga të cilat 19 raste kanë qënë raste të reja dhe 28 kliente të mëparshme të qendrës.
- Referimi i rasteve pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) bashkia Kamëz është bërë me qëllim përfshirjen e rasteve në programet mbështetëse dhe asistimin e tyre nëpërmjet ndihmave sipas specifikës së rasteve konkrete. Pranë bashkisë Kamëz dhe njësisë administrative Paskuqan janë referuar 8 raste.
- QDNJD ka ofruar këshillim ligjor për 47 raste kryesisht në lidhje me çështjet me objekt: lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, zgjatjen e afatit të UM, ekzekutimin e UMM/UM, dënimin e dhunuesit, kujdestari fëmijë, zgjidhje martesë, përfitim nga programet mbështetëse etj.
- anë përfaqësuar në gjykatë për çështje me objekt lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes për 4 raste. Gjatë kësaj periudhe QDNJD ka qënë në kontakt të vazhdueshëm jo vetëm me kliente të qendrës (të mbijetuara nga dhuna në familje) por edhe me institucionet përgjegjëse të linjës në mënyrë të veçantë komisariatit e policisë dhe bashkinë Kamëz në funksion të mbështetjes së të mbijetuarave nga dhuna familje dhe përmirësimit të situatës së tyre, në disa raste të rënduar për shkak të karantinës.

Kjo qendër gjatë periudhës janar-prill 2020 për bashkinë Tiranë ka trajtuar:

- 96 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare me konsulencë ligjore, nga të cilat 24 raste janë përfaqësuar falas në Gjykatë;
- Ka ofruar mbështetje për rastet e dhunës në familje që ka konsistuar në ofrimin e shërbimeve ligjore falas si psh. Konsulencë ligjore, hartim dokumentacioni ligjor, përfaqësim në Gjykatë në çështjet me objekt lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, konfirmimin e Urdhërit të Mbrojtjes dhe Ndryshimin e Urdhërit të Mbrojtjes.
- Rastet e trajtuara nga QDNJD gjatë kësaj periudhe kohore janë referuar nga Komisaritet Nr. 4 dhe 6, Zyra për të Miturit dhe Dhunën në familje pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, Njësia Administrative Nr. 3, 4, 6, 8, Bashkia Tiranë.

Të ndara sipas muajve:

Janar: 23 raste kanë marrë konsulencë ligjore, 6 raste janë përfaqësuar falas në gjykatë;

Shkurt: 21 raste kanë marrë konsulencë ligjore, 8 raste janë përfaqësuar falas në gjykatë;

Mars: 23 raste kanë marrë konsulencë ligjore, 5 raste janë përfaqësuar falas në gjykatë;

Prill: 29 raste kanë marrë konsulencë ligjore, 5 raste janë përfaqësuar falas në gjykatë

"Strehëza për Gra dhe Vajza"

Në bashkinë Lezhë - Strehëza gjatë periudhës pandemike ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të kësaj bashkie. Kjo strehëz ka mbështetur me pako ushqimore 15 raste të dhunës në familje të pajisura me Urdhër Mbrojtje, 3 prej tyre i kanë mbështetur me shërbime psikologjike dhe 5 fëmijë të grave të dhunuara po mbështeten në procesin mësimor me materiale dhe me pagesën e internetit. Të gjitha rastet që strehëza ka mbështetur në këtë periudhë janë raste të identifikuara përpara datës 11 mars.

Në bashkinë Tiranë, kjo strehëz gjatë periudhës janar-prill 2020 ka trajtuar 13 raste gra dhe vajza si dhe 8 fëmijë. Të gjitha rastet e trajtuara kanë marrë shërbimin e plotë në strehëz (strehim, mbështetje psiko-sociale, mbështetje ligjore, regjistrim në kurset e formimit profesional/punësim).

Qendra Kombëtare e Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje (QKTVDH)

Pranë QKTVDH janë akomoduar banorë të rinj edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 ku kanë marrë edhe shërbimet përkatëse. Në muajin mars është akomoduar 1 rast i ri (1 grua pa fëmijë) e referuar nga komisariati i policisë Kamëz. Në muajin prill janë akomoduar 2 raste të reja (1 vajzë e mitur e pashoqëruar, viktimë e dhunës seksuale, referuar nga Qendra Liliun dhe 1 grua nga Kosova e referuar nga komisariati i policisë Kamëz.

Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Lezhë

Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Lezhë mbështetet nga Fondacioni Mary Ward Loreto. Mbështetja e dhënë gjatë periudhës pandemike ka konsistuar në mbështetjen e rasteve të dhunës me pako ushqimore dhe artikuj higjienikë, për 10 gra kryefamiljate që kanë patur problematika me dhunën në familje. Gjatë kësaj periudhe kjo qendër ka ndjekur trajnimin për protokollin e ri të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për masat e reja që duhet të ndiqen për rastet e dhunës në familje në situatë pandemie.

Unë Gruaja

Në bashkinë Pogradec, Shoqata "Unë gruaja" gjatë periudhës së pandemisë nga 17 rastet e reja të identifikuar, ka ofruar mbështetje psikologjike për 9 prej viktimave të dhunës në familje. Disa raste janë referuar pranë rrjetit AWEN dhe organizata të tjera sipas nevojës. Një rast është referuar tek Rrjeti i Grave të Kosovës pasi referimi erdhi nga Kosova dhe 48 raste të tjera të mbartura janë diskutuar me Koordinatorin vendor apo Administratorët e Njësive Administrative pasi kërkesat e tyre lidhen me çështjet ekonomike gjatë kësaj periudhe. Shoqata ka ofruar nëpërmjet avokatit dhe psikologut të saj mbështetje ligjore dhe psikologjike për disa raste të referuara. Për periudhën mars- prill 2020 shoqata "Unë Gruaja" ka ofruar këshillim psikologjik e juridik nëpërmjet telefonit dhe rrjeteve sociale dhe platformës Ehat's up. Kjo organizatë ka realizuar në total 138 seanca këshillimi.

Organizata "Jona"

Në bashkinë Sarandë, në muajt mars dhe prill organizata ka pritur 29 telefonata, telefonata këto nga gra/vajza të cilat të ndikuara nga frika e karantinimit me dhunuesin kanë kërkuar ndihmë dhe i'u është ofruar ndihmë këshillimore psikologjike. Gjithashtu edhe nevojat ekonomike të referuara nga këto telefonata, për ushqime apo ndihma të tjera, janë përçuar nga organizata pranë bashkisë Sarandë.

Organizata "Gruaja tek Gruaja"

Pranë bashkisë Shkodër që nga janari i 2020, organizata "Gruaja tek Gruaja" ka marrë në total 110 telefonata. Të gjitha telefonatat kryefjalë kanë patur dhunën në familje. Sipas nevojës së paraqitur nga telefonuesit, organizata ka referuar këshillim psikosocial për 136 raste dhe këshillim ligjor për 56 raste. Gjatë muajit mars kjo organizatë ka pritur 34 telefonata duke ofruar këshillim psiko-social për 32 prej tyre dhe për 15 raste ofroi këshillim ligjor. Ndërkohë që në muajin prill numri i rasteve pësoi rritje duke numëruar 45 telefonata të tilla ku për 33 raste u ofrua këshillim psiko-social dhe për 12 raste u ofrua këshillim ligjor. Kjo organizatë ka referuar edhe pranë bashkisë Shkodër 2 raste të grave në nevojë, ku është ofruar edhe ndihma nga ana e bashkisë.

Qendra "Vatra"

Për rastet e grave dhe vajzave që kërkojnë këshillim dhe asistencë në komunitet, Qendra "Vatra" **Vlorë** ka vendosur në dispozicion të publikut numrat e kontaktit të specialistëve (psikolog, avokat, punonjës social) të cilët kanë ofruar shërbimet përkatëse nëpërmjet telefonit 24 orë/ditë.

Prej datës 11 mars, 55 gra dhe vajza viktime të dhunës në familje kanë telefonuar në numrin e kontaktit të Klinikës Ligjore të Qendrës "Vatra" për të kërkuar ndihmë dhe për të ngritur problematikat e tyre. Kryesisht, telefonanat kanë qenë të natyrës:

- Për të kërkuar ndihmë ekonomike nisur nga situata e izolimit.
- Për të kërkuar informacion lidhur me çështjen e tyre civile/penale (*raste të cilat kanë qenë duke u mbështetur me asistencë ligjore para periudhës së izolimit*).
- Për të raportuar dhunën.

Për 42 vajza dhe gra, viktime të dhunës në familje, specialistët kanë ofruar mbështetje direkte, si:

- përfaqësim në gjykatë për pajisjen me urdhra mbrojtje;
- mbështetje psikologjike në komisariatit e Policisë për viktime të dhunës;
- këshillim ligjor nëpërmjet telefonit;
- këshillim psikologjik nëpërmjet telefonit;
- 18 përfutuese (56 anëtarë të familjeve të tyre, prej të cilëve 30 fëmijë), gjatë muajit prill, u mbështetën me paketa ushqimore dhe materiale higjieno-sanitare për gra, viktime të dhunës në familje të cilat po përballen me vështirësi ekonomike.

Me qëllim mospërshkallëzimin e dhunës së ushtruar në familje në kushte izolimi, këshilluesit për burrat dhunues ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve këshillimore për burrat dhe djemtë dhunues.

Që prej datës 11 mars, 8 djem dhe burra dhunues janë mbështetur me këshillime psiko-sociale përmes telefonit. Shërbimi është fokusuar në manaxhimin e agresivitetit, forcimin e vetkontrollit, përmirësimit të marrëdhënieve brenda familjes, etj.

13 raste të cilat kanë kërkuar ndihmë ekonomike pranë Qendrës Vatra dhe për shkak të nevojave të vlerësuara janë referuar për mbështetje pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë. Për rastet që kanë paraqitur nevoja emergjente, është bërë referimi i tyre pranë institucioneve përkatëse.

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Gjatë periudhës janar – prill për bashkinë Tiranë është bërë i mundur ofrimi i këshillimit të 36 personave të cilët kanë pranuar me dëshirë të marrin pjesë në këtë program. Gjatë muajit janar- shkurt shërbimi është ofruar ballë për ballë brenda institucioneve të IEVP ve, në ambjentet e Shërbimit të Provës dhe tek zyra e Linjës së Këshillimit. Ndërsa, gjatë periudhës së izolimit social për shkak të pandemisë shërbimi është ofruar nëpërmjet telefonit dhe platformës SKYPE, por me një kohëzgjatje të reduktuar.

Në Bashkinë e Shkodrës funksionon "Zyra për Djem dhe Burra" (ZDB) pranë organizatës "Gruaja te Gruaja", e cila ofron programe këshillimi dhe rehabilitimi për dhunuesit. Përgjatë kësaj kohe ata kanë vazhduar ofrimin e shërbimeve të tyre nëpërmjet këshillimit online/telefonik, si dhe kanë hartuar një manual, të shkurtër dhe praktik, për t'iu ardhur në ndihmë, në veçanti të gjithë djemve dhe burrave që ndihen të pasigurt ndërkohë që ndodhen në karantinim. Përgjatë periudhës janar-prill ZDB, pranë shoqatës "Gruaja te Gruaja" ka trajtuar 16 raste në total, ndër të cilët 10 janë burra të dhunshëm dhe 6 të tjerë janë djem nën moshën 18 vjeç që kanë patur probleme me agresivitetin. Para situatës së shkaktuar nga COVID-19 janë trajtuar 12 raste, ndërsa përgjatë periudhës së COVID-19 kjo zyrë ka trajtuar 4 raste.

KONKLUZIONE

Në një vështrim krahasues vihet re se përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ka një ulje të raportimeve për dhunë në familje në të gjitha bashkitë apo edhe në rang kombëtar në lidhje me dhunën me bazë gjinore apo në marrëdhëniet familjare. Por nga ana tjetër ka një rritje të madhe të rasteve të raportuara pranë Linjës Kombëtare të Këshillimit për Gra e Vajza (LKKGV). Ky numer është më i madh edhe në krahasim me raportimet e dhunës dhe kërkesat për UM/UMM pranë komisariateve të policisë apo vendimeve në gjykata.

LKKGV ka marrë 947 telefonata në muajin mars 2020 dhe 975 telefonata në muajin prill 2020. Përveç dhunës, telefonueset kanë raportuar për probleme të ndryshme të natyrës socio-ekonomike si dhe në lidhje me ankthin dhe depresionin e shkaktuar nga izolimi.

Komisariatet e Policisë kanë marrë 104 raportime në mars 2020 dhe 114 raportime në prill 2020.

Gjykatat e rretheve gjyqësore kanë dhënë rreth 89 UM/UMM gjatë muajit mars 2020 dhe 123 UM/UMM gjatë muajit prill 2020. MKR-të e 11 bashkive kanë trajtuar gjithsej 49 raste gjatë muajit mars 2020 dhe 48 gjatë muajit prill 2020.

Faktorët për një raportim shumë herë më ulët mund të jenë të shumtë e kryesisht të lidhur me faktin e masave kufizuese gjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19. Mungesa e lirisë së daljes i vendosi viktimat dhe dhunuesit brënda njësisë shtëpiake, duke i bërë më të pasigurta për t'iu drejtuar Policisë apo Gjykatës për të denoncuar dhunën e ushtruar ndaj tyre.

Përgjatë periudhës së pandemisë bashkitë kanë ofruar pako ushqimore dhe sanitare për viktimat e dhunës në familje për rastet e dhunës të evidentuara jo vetëm përgjatë katër muajve të parë të vitit 2020, por gjithashtu edhe për viktimat të dhunës të trajtuara më herët nga Mekanizmi.

Gjykatat e Rrethit Gjyqësor në zbatim të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor²¹ nga data 10 – 25 Prill kanë zhvilluar seancat në lidhje me UMM/UM dhe vërtetimet e tyre, duke i konsideruar si çështje me natyrë të ngutshme të vlerësuara rast pas rasti nga Gjyqtari. Me miratimin e Aktit Normativ Nr.9 datë 25.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"²² u përcaktua shprehimisht zhvillimi i seancave

21 <http://klgj.al/covid-19/> Njoftimet e KLGJ datë 10 Mars, 24 Mars, 7 Prill, 24 Prill

22 <http://qzb.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/25/9> Akti Normativ Nr. 9 datë 25.03.2020 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 50 datë 25.03.2020

gjyqësore në çështjet familjare me objekt masat mbrojtëse ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjykatat e rrethit Gjyqësor kanë vazhduar me gjykimin e çështjeve urgjente të tilla si UMM/UM si dhe masat e sigurimit personal. Në rastin e UMM/UM Gjykata ka vepruar dhe me zhvillimin e këtyre procesve në mungesë të palëve ndërgjyqëse, viktimës dhe dhunuesit, duke u munduar të mos rrezikojë jetën dhe shëndetin e tyre në situatën e COVID-19. Në këtë rast trupi gjykues vlerësonte në lëshimin apo jo të UMM/UM provat e përcjella në kërkesë padë nga ana e Drejtorive Vendore të Policisë së qarqeve. Nga ana tjetër Gjykatat e Rrethit Gjyqësor në pjesën më të madhe të seancave të vërtetimit të UMM kanë vendosur pushimin e tyre. Kjo tregon se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk arrijnë të provojnë para Gjykatës se përgjatë kohëzgjatjes së UMM janë shkelur urdhërimet e gjykatës.

Gjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 asnjë bashki nuk ka prodhuar e shpërndarë materiale informuese se ku mund të kërkohet ndihmë në rastet e dhunës dhe kontaktet e nevojshme. Këto publikime janë bërë nga organizata të shoqërisë civile. Disa bashki kanë ndarë spotin informues për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në situatën Covid 19 (shoqëruar edhe me gjuhën e shenjave) të përgatitur nga MShMS.

Në disa nga bashkitë e mëdha të Shqipërisë vazhdon të mbetet problem ngritja e një qendre residencale apo strehëze emergjence për trajtimin e viktimave të dhunës në familje. Koordinatorët vendore kundër dhunës në familje, pranë bashkive kanë punuar gjatë pandemisë dhe kanë qenë të angazhuara edhe me detyra të tjera që nuk i përkasin profilit, duke shpenzuar një kohë të madhe në terren në ndihmë të familjeve në nevojë për shpërndarje pakosh ushqimore apo pjesë e grupeve të patronazhit për banorët e moshës së tretë të kësaj bashkie.

Për shkak të situatës së pandemisë institucionet shtetërore lokale janë fokusuar tërësisht në zbatimin e rregullave të izolimit nga popullsia dhe mbështetjen me ndihma të kategorive në nevojë duke mos u fokusuar mjaftueshëm çështjeve të dhunës ose duke u mjaftuar vetëm me ndihmë në pako ushqimore, higjieno-sanitare ndaj tyre ose këshillime online. Pagesa për UM/UMM prej 3000 lekë është dyfishuar sipas urdhrin të qeverisë shqiptare pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore. Sidoqoftë nuk ka të dhëna të qarta nëse UM/UMM e dhëna më parë dhe që përfundonin në muajt mars, prill apo maj të jenë vazhduar automatikisht, pasi nuk ka patur asnjë urdhëresë në lidhje me këtë.

Bashkëpunimi i bashkive me organizatat e shoqërisë civile pjesë e mekanizmit ose jo, por që operojnë në territorin përkatës dhe ofrojnë ndihma dhe shërbime për viktimat e dhunës në familje, ka qenë shume i mirë.

Disa Bashki si Tirana, Durrës dhe Lezha janë trajnuar për protokollin e përgatitur nga MSHMS në lidhje me funksionimin e MKR në kohë pandemie.

REKOMANDIME

- Kërkohet funksionim i plotë i mekanizmave të referimit në nivel bashkie dhe përfaqësim i çdo institucioni anëtar në takimet e përmuajshme.
- Mbajtja e minutave të rregullta dhe proces verbaleve të mbledhjeve në rastin e vendimeve të rëndësishme për viktimat e dhunës në familje.
- Angazhim i Institucioneve arsimore në nivel vendor dhe marrja përsipër e detyrimeve që rrjedhin nga ligjet dhe strategjitë në fuqi për tu kujdesur për fëmijët që shoqërojnë rastet e dhunës në familje dhe për të raportuar dhunën sapo e pikasin.
- Anagazhim i Institucioneve shëndetësore në nivel vendor për të raportuar viktimat e dhunës sipas detyrimeve ligjore që këto institucione kanë.
- MShMS në bashkëpunim me donatorët duhet të krijojë një modul trajnimi online që tu vihet në dispozicion Koordinatorëve Vendore kundër dhunës me bazë gjinore dhe/apo punonjësve të barazisë gjinore në nivel vendor. Punonjësit/et e rinj/reja në këto detyra duhet ta ndjekin dhe të kenë njohuri të mjaftueshme sapo të filojnë punën e jo të presin me muaj të trajnohen.
- Propozojmë ndryshim në Ligjin për Masa ndaj dhunës në familje në lidhje me vendosjen e sanksioneve për pjesëmarrjen dhe anagazhimin e institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në nivel vendor.
- Bashkitë nën monitorim kanë detyrim ligjor të forcojnë mekanizmat e bashkërendimit ndër institucional dhe MKR-të në zhvillimin dhe zbatimin e politikave për të frenuar dhunën ndaj grave gjatë pandemisë dhe përtej.
- Të bëhet mbledhja dhe ndarja gjinore e të dhënave, përfshirë të dhënat administrative dhe të dhënat e regjistruara nga shërbimet e specializuara të ndihmës, të cilat mund të shërbejnë për të gjurmuar trendet dhe daljet e mundshme në kërkesat e viktimave për ndihmë.
- Duhet të forcohet mekanizmi i referimit i cili duhet të mbliidhet rregullisht, të mbajë minuta, foto, të marrë vendime në lidhje me rastet që trajton.
- Mekanizmi i referimit dhe vetë bashkia duhet të marrin në konsideratë marrjen e masave, siç janë njoftimet për shtyp, fushatat televizive, radio ose mediat sociale, që synojnë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë mbi rritjen e rrezikut të dhunës ndaj grave dhe vajzat gjatë pandemisë dhe përhapjen sa më shumë të jetë e mundur të informacionit për rrugët e mundshme ku viktimat mund të marrin ndihmë.
- Pushteti vendor duhet të llojë pranë qeverisë në lidhje me marrjen në konsideratë të masave për të rritur ndërgjegjësimin midis zyrtarëve shtetërorë dhe publikë që veprojnë në sektorë kritikë (shëndetësia, drejtësia, zbatimi i ligjit) në lidhje me

ndikimin e mundshëm të masave të tilla si distancimi shoqëror, bllokimet ose rregullat e punës, dhe në përgjithësi të pasojave ekonomike dhe sociale të krizës për gratë dhe fëmijët që jetojnë në një marrëdhënie të dhunshme dhe / ose mjedis shtëpiak.

- Autoritetet gjithashtu mund të inkurajojnë profesionistët, të tilla si avokatët dhe stafi që veprojnë në shërbime mbështetëse për viktimat, të promovojnë dhe të përfshihen në trajnime duke u mbështetur në burimet ekzistuese të trainimit (mësime online, webinars dhe module trajnimi) të zhvilluara si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.
- Bashkitë duhet të kenë parasysh Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020 dhe të marrin masa për zbatimin sidomos të Qëllimit strategjik nr. 3 e të gjitha objektivave specifike të qëllimit 3 të strategjisë.
- Bashkia dhe policia të bashkëpunojnë për shumicën e rasteve me UM dhe UMM me plane specifike sipas rasteve.
- Të vlerësohet risku dhe të pajisen me bonus qeraje nga bashkia viktimat e dhunës në familje në rastet kur strehëzat kombëtare nuk kanë kapacitet dhe viktimat nuk kanë mundësi të strehohet në familjen e origjinës.
- Strehëzat qofshin ato emergjence apo strehëzat kombëtare duhet të funksionojnë në mënyrë të rregullt dhe të jenë çatia mbi kokën e vajzave dhe grave të dhunuara.
- Duhet të sigurohen kanale të reja për gratë që raportojnë dhunën siç mund të jenë nxitja e përdorimit të fjalëve kod në farmaci për viktimat për të raportuar dhunën e partnerit intim dhe / ose dhunën në familje gjatë mbylljes.
- Siguria e viktimave dhe fëmijëve të tyre duhet të mbetet shqetësimi parësor për të gjitha institucionet pjesë e mekanizmit të referimit si dhe autoritetet gjyqësore.
- Në bashkëpunim me Policinë, Njësitë e Vete qeverisjes Vendore/mekanizmi i referimit (NjVV/MR) duhet të kryejnë monitorimin e rasteve për të cilat është dhënë UMM ose UM, në veçanti kur viktimat dhe dhunuesit jetojnë në të njëjtën banesë. Brenda mundësive, këto raste duhet të verifikohen shpesh nëpërmjet vizitave ose telefonatave/sms-ve dhe viktimave duhet tu krijohet mundësia të komunikojnë me autoritetet jo në prani të dhunuesit.
- Akomodimin e viktimës në qendrat e emergjencës, duke respektuar protokollin në fuqi për parandalimin e COVID-19 ose gjetja e një akomodimi alternativ të përshtatshëm.
- Monitorimi i UM, të cilave u përfundon afati gjatë periudhës së izolimit, në veçanti kur viktimat ndjehen ende të rrezikuara por nuk kanë mundësi për shkak të izolimit të kërkojnë shtyrjen.
- Përfaqësuesit e pushtetit vendor, gjatë vizitave në terren si pjesë e skuadrave të emergjencës, duhet të vëzhgojnë me kujdes për shenja të mundshme të incidenteve të dhunës që mund t'u kenë ndodhur grave/fëmijëve që takojnë.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. "Abdyl Frasheri" Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë

Qendra
"Aleanca Gjimore për Zhvillim"

www.gadc.org.al